

Shqyrtim i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë

Qershor 2016

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. HYRJE	5
2. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE E KOSOVËS.....	7
2.1. Korniza ligjore ndërkombëtare	7
2.2. Korniza ligjore e Kosovës.....	8
3. BRENGAT E IDENTIFIKUARA NË ZBATIMIN E KPP.....	8
3.1. Gjykimet me të pandehur pa mbrojtje: brengë mbizotëruese që ndikon në zbatimin e dispozitave të reja të KPP	8
3.1.1. Caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike	9
3.1.2. Ndikimi i mospërfaqësimit të të pandehurit në sistemin akuzator.....	12
3.2. Roli i ri i mbrojtjes.....	14
3.2.1. Kërkesat për marrjen e provave shfajësuese nëpërmjet prokurorisë	14
3.2.2. Kundërshtimi i ekspertëve të përzgjedhur nga prokuroria.....	17
3.2.3. Detyrimi i zbulimit të provave.....	18
3.2.4. Kundërshtimi i aktakuzës.....	19
3.2.5. Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve.....	19
3.3. Roli i ri i prokurorisë.....	20
3.3.1. Deklaratat e dëshmitarit në procedurën paraprake: marrja në pyetje në procedurë paraprake dhe deklarata në procedurë paraprake.....	20
3.3.1.1. Dy lloje të reja të dëshmimeve të dëshmitarit.....	20
3.3.1.2. Deklaratat në procedurë paraprake dhe drejta e të pandehurit për marrjen në pyetje të tërthortë të dëshmitarit.....	23
3.3.2. Mbështetja e pohimit.....	24
3.3.3. Negocimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë.....	25
3.3.3.1. Administrimi efektiv i drejtësisë.....	25
3.3.3.2. Pranimi i fajësisë gjatë procedurave të rregullta	26
3.3.4. Alternativat tjera ndaj gjykimit.....	28
3.4. Roli i ri i palës së dëmtuar	28
3.4.1. Deklarimi i dëmeve.....	29
3.4.2. Mbrojtësi i viktimës gjatë gjykimit.....	30
3.4.3. Prania e palës së dëmtuar gjatë shqyrtimit fillestar dhe të dytë.....	31
3.5. Roli i ri i gjyqtarit	32
3.5.1. Afatet kohore që kanë të bëjnë me paraburgimin	32
3.5.2. Afatet kohore për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor.....	33
3.5.3. Data e aktgjykimit me shkrim.....	33
3.5.4. Rishikim i sfidave me aktakuzat.....	34
3.5.5. Audio/video regjistrimi i shqyrtimit gjyqësor.....	35
4. PËRFUNDIM.....	37
5. REKOMANDIMET	39

SHKURTESAT

DP	Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatave Themelore
DKR	Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatave Themelore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
KPPP	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë
PNDCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron një pasqyrë të përgjithshme të zbatimit të Kodit të ri të procedurës penale (KPKK) që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, bashkë me pjesë tjera legjislative që e reformojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë. KPP ka futur ndryshime të mëdha në procedurat penale në Kosovë, duke e konsoliduar një ndryshim nga sistemi fillimisht inkuizitor i vendosur para vitit 2003- kryesisht në fuqi gjatë viteve 2003 - 2012, në një sistem që karakterizohet kryesisht si akuzator.

Sipas KPP të ri, mbrojtjes dhe prokurorisë u janë dhënë role të zgjeruara në mënyrë të konsiderueshme, si në fazën paraprake ashtu dhe në gjykim, ku gjyqtarëve u janë dhënë përgjegjësi dhe kompetenca të reja që u mundësojnë atyre të veprojnë më mirë si mbrojtës të të drejtave të palëve në vend se të shërbejnë si mbledhës primarë të provave. Në të njëjtën kohë, viktimave u është dhënë statusi i palës në procedurë, duke zëvendësuar praktikën afatgjatë të mundësisë së marrjes së ndjekjes si prokurorë subsidiar.

Megjithatë, KPP ishte publikuar vetëm tri ditë para se të hynte në fuqi, dhe nuk kishte kohë për të siguruar trajnim të gjerë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve se si t'i zbatojnë dispozitat e këtij kodi të ri dhe që të kuptonin më mirë rolin e tyre të ri në procedurat akuzatore. Prandaj, ky raport shqyrton nëse mbrojtja, prokurorët, gjyqtarët dhe palët e dëmtuara janë duke i pranuar rolet dhe përgjegjësitë e tyre të reja të parashikuara në kodin e ri në faza të ndryshme të procedurës.

Raporti gjen se shumica e procedurave kritike të reja të futura në KPP nuk janë duke u zbatuar si duhet, ose nuk janë duke u zbatuar fare. Mbrojtja shpesh nuk i përmbush përgjegjësitë e saj të reja në praktikë, sidomos kur i pandehuri nuk është i përfaqësuar nga një avokat mbrojtës. Të pandehurit, të vetëm, zakonisht nuk janë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre. Edhe në rastet kur avokati mbrojtës është i pranishëm, mbrojtja shpesh nuk përfshihet në procedurë në mënyrë aktive aq sa duhet. Raporti gjithashtu konstaton se prokurorët në përgjithësi vazhdojnë të kryejnë rolin e tyre gjatë procedurës ashtu siç e kanë bërë para hyrjes në fuqi të KPP-së të ri. Për shembull, ata nuk kanë ndryshuar mënyrën se si marrin deklaratat në procedurë paraprake nga dëshmitarët dhe shumë rrallë përdorin alternativa ndaj gjyqimit. Për më tepër, palët e dëmtuara përballen me vështirësi për të gjetur pozitën e tyre të re në procedurë. Mbetet e paqartë nëse ata duhet të ftohen për shqyrtimin e parë dhe të dytë para se të fillojë gjykimi. Së fundi, gjyqtarët shpesh nuk kryejnë rolin e tyre si mbrojtës të të drejtave të palëve. Afatet kohore për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor nuk respektohen gjithmonë dhe vazhdon të ketë mangësi në procesin e konfirmimit të aktakuzës.

Ndryshimi apo kalimi i paraparë në KPP në sistem kryesisht akuzator nuk shihet në praktikë. Moszbatimi i dispozitave të KPP të ri, i cili është projektuar për të fuqizuar të drejtën e të pandehurve për gjykim të drejtë, duket aq i përhapur sa që mund të rezultojë në shkelje të përgjithshme të drejtës së të pandehurve për gjykim të drejtë.

Raporti konkludon që gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve duhet të ju ofrohet trajnim i hollësishëm shtesë në të drejtën procedurale penale ashtu që t'i kuptojnë më mirë dispozitat e reja. Kjo do të adresonte mangësitë më të theksuara të vërejtura aktualisht, meqë ato vijnë si rezultat i mungesës së trajnimeve adekuate për gjyqësorin para miratimit të kodit të ri. Gjithashtu, gjyqtarëve ju rikujton që t'i informojnë si duhet të pandehurit për të drejtën e tyre për mbrojtës me shpenzime publike, në raste kur kushtet për mbrojtje të detyrueshme nuk përmbushen. Raporti paraqet edhe rekomandime për gjyqtarët, avokatët, të pandehurit, palët e

dëmtuara, mbrojtësit e viktimave, dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për zbatim më të mirë të dispozitave të reja të kodit.

1. HYRJE

Raporti i shtjellon gjetjet e monitoruesve të sektorit të drejtësisë të OSBE-së përkitazi me zbatimin e KPP-së që ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, bashkë me legjislacionin tjetër që e reformon sistemin e drejtësisë në Kosovë.¹ Kodi i ri i procedurës penale ka sjell një ndryshim duke bërë ndërrimin nga sistemi inkuizitor në sistem akuzator. Në sistemin akuzator, përgjegjësia kryesore për mbledhjen dhe paraqitjen e provave qëndron me prokurorinë dhe mbrojtjen, ndërkaq gjyqtari vepron si një arbitër i paanshëm duke siguruar proces të drejtë gjyqësor. Ndryshe nga kjo, në sistemin inkuizitor gjyqtari luan një rol aktiv në mbledhjen e provave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, ndërkaq palët kanë rolë më të kufizuar në këtë drejtim.

Raporti shqyrton nëse ka pasur edhe ndryshim praktik, më saktë, nëse mbrojtja, prokurorët, gjyqtarët dhe palët e dëmtuara kanë pranuar rolet dhe përgjegjësitë e reja gjegjëse të përcaktuara në kodin e ri në faza të ndryshme të procedurës. Për të vlerësuar nëse janë përqaftuar rolet e reja nga akterët e ndryshëm në procedurë penale, OSBE ka zhvilluar një vlerësim gjithëpërfshirës cilësor dhe sasior të të dhënave të mbledhura përmes: monitorimit të aktiviteteve gjyqësore mes gjatë viteve 2013-2015; anketës së kryer në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2014, për të parë se si gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët i kanë praktikuar dispozitat e reja të KPP; dhe intervistave me bashkëbisedues të ndryshëm si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, dhe mbrojtës të viktimave. OSBE gjithashtu ka marrë shënim për çështjet e ngritura nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët gjatë punimeve të grupeve të punës të ngritura nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në nëntor 2013 për të diskutuar rreth reformave në sistemin e drejtësisë në vitin 2013, dhe në maj të vitit 2015 kur gjyqtarët pranuan se kanë vështirësi në zbatimin e dispozitave të KPP-së në rastet kur të pandehurit nuk përfaqësohen nga avokatë mbrojtës. Në raste të caktuara, të dhënat e mbledhura nga monitorimi i punës në gjykata kanë qenë të kufizuara për shkak të mungesës së qasjes në shkresat e lëndës nga faza e hetimeve.

Në vitin 2013, OSBE monitoroi procedurat në 215 lëndë penale, 122 në departamente të përgjithshme dhe 93 nëpër departamente të krimeve të rënda të gjykatave themelore.² Gjysma e parë e vitit 2013 ishte periudhë e vështirë e tranzicionit sepse, krahas KPP-së, në fuqi hyri edhe Ligji për gjykatat.³ Për më tepër, shumë raste të monitoruara në muajt e parë të vitit 2013 kishin filluar që në vitin 2012 dhe kishin vazhduar sipas kodit të mëparshëm të

¹ Kodi i procedurës penale, Ligji Nr 04/L-123, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13.12.2012, në fuqi nga 01.01.2013, është shpallur me dekret të Presidentit të Kosovës më 21.12.2012 (në tekstin e mëtejshëm i referuar si KPP). Ligji i ri për gjykatat gjithashtu ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013: Ligji për gjykatat, Ligji Nr 03/L-199, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 22.07.2010. Ky ligj, në fuqi nga data 01.01.2013, është shpallur me dekret të Presidentit të Kosovës më 09.08.2010.

² Monitorimi i rasteve do të thotë më shumë se sa thjeshtë vëzhgim të rastit gjatë shqyrtimit; monitoruesit gjithashtu kanë shikuar edhe shkresat e lëndëve dhe kanë mbledhur dokumente relevante si mocionet e mbrojtjes për hedhjen e aktakuzës dhe vendimet për refuzimin apo lejimin e mocioneve të tilla, deklaratave të dëshmitarëve të marra gjatë fazës së hetimeve, etj. Mbledhja e këtyre dokumenteve nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunimin e interlokutorëve nëpër gjykata.

³ Në Prishtinë/Priştina, për shembull, departamenti i ri për krime të rënda ishte thujse jofunksional për disa muaj me radhë për shkak të fillimit të punëve rindërtuese në ndërtesën ku gjendej në janar 2013.

procedurës, sipas dispozitave kalimtare (të diskutueshme).⁴ Monitorimi zbuloi që ka mangësi të theksuara në mënyrën së si po zbatohet KPP. Si rezultat i kësaj faze preliminare të monitorimit, në vitin 2014, OSBE dizajnoi një plan monitorimi më të përqendruar me fokus më të madh në zbatimin e dispozitave të reja të KPP në faza të ndryshme të procedurës paraprake dhe procedurës gjyqësore. Prandaj, mes janarit 2014 dhe qershorit 2015, OSBE monitoroi 1772 shqyrtime në 906 lëndë penale në departamentin e përgjithshëm dhe departamentin për krime të rënda, sipas ndarjes së paraqitur më poshtë:

Shqyrtimi fillestar	DP	324 shqyrtime (nga të cilat 216 ishin shqyrtime produktive) ⁵
	DKR	234 shqyrtime (192 shqyrtime produktive)
Shqyrtimi i dytë	DP	50 shqyrtime (40 shqyrtime produktive)
	DKR	87 shqyrtime (71 shqyrtime produktive)
Shqyrtimi kryesor	DP	597 shqyrtime (371 shqyrtime produktive)
	DKR	480 shqyrtime (380 shqyrtime produktive)

Shqyrtimet u monitoruan në të shtatë Gjykatat Themelore të Kosovës:⁶

	Gjilan/ Gnjilane	Prishtinë/ Priština	Ferizaj/ Uroševac	Gjakova/ Djakovica	Mitrovicë/ Mitrovica	Pejë/ Peć	Prizren	Total
DP	109	185	69	50	189	194	175	971
DKR	51	197	20	107	122	106	198	801

Monitoruesit e OSBE-së gjithashtu mblodhën dhe analizuan 196 aktgjykime me shkrim, nga të cilat 71 nga departamentet për krime të rënda, si dhe 125 nga departamentet e përgjithshme.

Për t'i verifikuar vëzhgimet e monitoruesve të saj, OSBE punoi ngushtë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës për të anketuar gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët për përdorimin e dispozitave të reja të KPP.⁷ Tetëdhjetë avokatë u përgjigjën në pyetjet e pyetësorit (nga 570 avokatë të regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës në mes të vitit 2014); 56 prokurorë (nga 160 brenda sistemit prokurorial të Kosovës); dhe 70 gjyqtarë penalistë që punojnë në departamentet e përgjithshme dhe të krimeve të rënda (nga 170 sa janë në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë). Veç kësaj, gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2014, OSBE mbështeti Këshillin Gjyqësor të Kosovës në organizimin e 14 punëtorive me gjyqtarë, prokurorë dhe

⁴ Shih Opinionet e Gjykatës Supreme më 15 dhe 23 janar 2013 (43/2013 dhe 56/2013 respektivisht).

⁵ Një “shqyrtim produktiv” është shqyrtimi gjatë të cilit ka ndodhur diçka me vlerë apo substanciale. Për shembull, janë siguruar prova, janë dëgjuar mocione apo është vendosur për mocion, ose janë diskutuar çështje të menaxhimit të rastit.

⁶ Këto përfshijnë, shqyrtime fillestare, shqyrtime të dyta dhe shqyrtimin në seancë kryesore dhe kanë përfshirë shqyrtime produktive dhe joproduktive.

⁷ Tre pyetësor të ndryshëm u janë dërguar gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, por pyetjet ishin të njëjta në të gjithë pyetësorët. Pyetësorët ruanin anonimitetin dhe pyetjet synonin të gjenin shpeshësinë e zbatimit të dispozitave të reja. Shpeshësia u mat në mënyrën apo pyetjet vijuese: “asnjëherë apo rrallëherë” (më pak se 20 për qind të rasteve); dhe “shpesh” (më shumë se 50 për qind të rasteve).

avokatë për të diskutuar rreth zbatimit të KPP dhe për t'i paraqitur konkluzionet dhe rekomandimet për zbatimin e KPP.⁸

Pjesa e dytë e këtij raporti paraqet një përmbledhje të kornizave ligjore ndërkombëtare dhe të Kosovës; që pasohet nga përvijimi i brengave të identifikuara në zbatimin e kodin e ri të procedurës. Raporti përmbillet me rekomandime për hisedarët gjegjësisht.

2. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE E KOSOVËS

2.1. Korniza ligjore ndërkombëtare

Kodet e procedurës penale janë garanci kundër zbatimit arbitrar të ligjeve penale. Ato janë të dizajnuara për të jetësuar të drejtën e personave të dyshuar dhe të pandehurve në raste penale për gjykim të drejtë, duke filluar nga kontakti fillestar me policinë e duke vazhduar gjatë fazës së arrestit, hetimit, shqiptimit të dënimit dhe apelit. Shpërfillja e procedurave të tilla mund të rezultojë në shkelje të të drejtave për proces të drejtë të të pandehurve, të mbrojtura me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, dhe nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Instrumentet ndërkombëtare në fjalë janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë.⁹

Për më tepër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur se barazia e palëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes gjatë procedurave penale është aspekt themelor i së drejtës për proces të drejtë.¹⁰ Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka përshkruar barazinë e palëve si gëzim i të drejtave të njëjta procedurale nga të gjitha palët, përveç në rast kur dallimet bazohen në ligj dhe mund të arsyetohen në baza objektive dhe të arsyeshme, duke mos e vendosur një palë në pozitë padrejtësisht të pafavorshme.¹¹ Prandaj, është detyrë jetike e gjykatave për të siguruar barazi të palëve, duke përfshirë mundësinë për t'i kundërshtuar argumentet dhe provat e paraqitura nga pala tjetër.¹² Pabarazia në prezantimin e rastit të njëjës nga palët, për shembull, ndikon në të drejtën e të mbrojtës për të ftuar dëshmitarë, e që është një nga aspektet e veçanta të së drejtës për proces të drejtë gjyqësor.¹³

⁸ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti i Konsoliduar përgatitur nga Raportuesi i Këshilli Gjyqësor i Kosovës* (në teksti e mëtuqjeshëm referuar si Raporti i Konsoliduar i KGJK), 29 nëntor 2014, <http://www.gjyqesori-rks.org/en/kjc/report/list/3>.

⁹ Neni 22 i Kushtetutës, 15 qershor 2008.

¹⁰ *Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar* KEDNJ, Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000 para 60. *Shih* gjithashtu, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat të Njeriut (ODIHR) f. 112.

¹¹ Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat të Njeriut, CCPR Koment i Përgjithshëm (2007), para. 13

¹² *Äärelä dhe Näkkäläjärvi kundër Finlandës*, Komunikatë e Komiteti të Kombeve të Bashkuara 1997, para 7.4; *Asch kundër Austrisë* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i datës 26 prill 1991, para 27.

¹³ Në *Nazarov kundër Uzbekistan*, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat të Njeriut refuzoi kërkesën e të pandehurit për caktim të ekspertit, gjë që mund të kishte siguruar prova jetike për rastin në gjykim. Në mungesë të ndonjë shpjegimi për arsyen e refuzimit të kërkesës së të pandehurit, Komisioni konkludoi se refuzimi binte ndesh me kërkesën për barazi mes prokurorisë dhe mbrojtjes në paraqitjen e provave dhe rrjedhimisht përbënte mohim të drejtësisë. Komunikatë e Komisionit për të Drejtat të Njeriut (2004), para 6.3.

2.2. Korniza ligjore e Kosovës

Në Kosovë janë ndërmarrë ndryshime të mëdha në rregullat e procedurës penale gjatë dekadave të fundit. KPP, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, ka futur një ndryshim nga sistemi i mëparshëm inkuizitor i zbatueshëm deri në vitin 2013, në sistem që kryesisht karakterizohet si akuzator.¹⁴ Për më tepër, sipas Udhëzuesit të KPP, që i është bashkëngjitur kodit të ri dhe që është menduar për t'ju ndihmuar praktikuesve në punën e tyre, ka pasur çështje serioze në kodin e mëparshëm të procedurës që është dashur të adresohen.¹⁵ Udhëzuesi gjithashtu sqaron që kodi tani përmban “elementë shumë të fuqishëm mbrojtës të drejtave të njeriut, që baraspeshojnë kapacitetin e shtetit për të hetuar dhe ndjekur.”¹⁶ Gjatë hartimit të kodit të ri, është marrë në konsideratë parimi i barazisë së palëve. Pikërisht për shkak të këtij parimi, janë shtuar disa dispozita në kodin e ri, ndërsa disa të tjera nga kodi i mëparshëm janë ndryshuar. Për shembull, disa dispozita në KPP të ri ia lejojnë të pandehurit të mbledh prova shfajësuese përmes prokurorit, duke ia dhënë kështu atij/asaj mundësinë për të siguruar prova të barabarta me ato të prokurorit.¹⁷

Sipas KPP të ri, roli i gjyqtarit dhe i palëve ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Roli i gjyqtarit ka ndryshuar në një më pak proaktiv gjatë procedurave, ndërsa mbrojtja dhe prokuroria kanë më shumë përgjegjësi. Prokurori ka detyrë më të madhe për zhvillimin dhe prezantimin e provave (“rasti i prokurorisë”). Në anën tjetër, mbrojtja siguron që prokurori ka vepruar si duhet dhe që i ka prezantuar provat e siguruar ligjërisht dhe ka ngritur aktakuzë të bazuar në ligj. Sipas KPP të ri, mbrojtja gjithashtu ka mundësinë për të kërkuar prova që mbështesin pozitën e të pandehurit, siç janë alibitë apo provat të cilat tregojnë se i pandehuri nuk ka pasur motiv për të kryer veprën. (“rasti i mbrojtjes”).¹⁸ Megjithatë, gjyqtari mbetet “mbrojtësi i të drejtave” dhe ka detyra të reja të qarta për të mbrojtur të drejtat e palëve.¹⁹ Përfundimisht, viktimave u është dhënë statusi i ‘palës’ në procedurë.

3. BRENGAT E IDENTIFIKUARA NË ZBATIMIN E KPP

3.1. Gjykimet me të pandehur pa mbrojtje: brengë mbizotëruese që ndikon në zbatimin e dispozitave të reja të KPP

Raporti merr parasysh dhe vëren kontekstin e veçantë të procedurave penale në Kosovë, ku një numër i madh i të pandehurve nuk përfaqësohen nga avokatë mbrojtës. Kjo është për shkak se caktimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike bëhet rrallëherë, përveç kur rasti i të pandehurit gjendet brenda listës së rasteve të përshkruara nga KPP si i tillë që patjetër kërkon caktimin e mbrojtësit, siç përshkruhet në fusnotën më poshtë.²⁰

¹⁴ Udhëzuesi për KPP, f. 11: sipas kodit të procedurave të mëparshme, procedurat përshkrueshin si “kuazi akuzator” ose “hibrid”.

¹⁵ Udhëzuesi për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtuftjeshëm Udhëzuesi për KPP), http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Udhzuesi-dhe-kodi-i-procedures_anglisht_225215.pdf. Shih çështje të përshkruara f.11.

¹⁶ Udhëzuesi për KPP, f. 11.

¹⁷ Udhëzuesi për KPP, f. 12-13.

¹⁸ Udhëzuesi për KPP, f. 27-30.

¹⁹ Udhëzuesi për KPP, f. 27.

²⁰ Shih nenin 57 Mbrojtësi në raste të mbrojtjes së detyruar të KPP. Mbrojtja është e detyruar, për shembull, kur i pandehuri është memec, i shurdhër apo kur shfaqë shenja të çrregullimit mendor apo paaftësie; gjatë shqyrtimeve gjyqësore për raste të paraburgimit dhe gjatë gjithë kohës sa i pandehuri është në paraburgim;

3.1.1. Caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike

Neni 58 i KPP parasheh një test të dyfishtë që duhet kryer nga gjykata gjatë vendosjes nëse do të caktohet mbrojtës me shpenzime publike për të përfaqësuar të pandehurin në raste kur nuk përmbushen kushtet për mbrojtje të detyrueshme. Mbrojtësi caktohet me shpenzime publike për të pandehurin me kërkesë të tij/saj nëse është në interes të drejtësisë dhe nëse i pandehuri nuk ka mundësi financiare për t'i mbuluar shpenzimet e mbrojtjes së tij/saj.²¹ Kodi i mëparshëm i procedurës ka pasur një dispozitë të ngjashme.²² KPP nuk ofron sqarime të mtejshme për kriterin e “interetit të drejtësisë”. Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe Liritë Themelore, e zbatueshme drejtpërdrejtë në gjykatat e Kosovës, përdorë megjithatë të njëjtat standarde dhe ka krijuar disa kriterë në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Me rastin e vendosjes nëse në interes të drejtësisë kërkohet përfaqësim ligjor pa pagesë, GJEDNJ shqyrton tre kriterë: 1) seriozitetin e veprës dhe lartësinë apo shkallën e dënimit; 2) kompleksitetin e rastit; dhe 3) mundësinë e të akuzuarit për të siguruar përfaqësim.²³

Neni 58 i KPP gjithashtu përfshinë një dispozitë të re me paragrafin 4, e cila kërkon nga i pandehuri plotësimin e një “deklarate ku ceket pasuria e tij/saj dhe ku deklarohet që ai/ajo nuk ka mundësi të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor”, para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike.

Monitorimi i kryer nga OSBE ka treguar që në 216 shqyrtime fillestare produktive të monitoruara në departamentet e përgjithshme gjatë periudhës janar 2014 dhe qershor 2015, nuk janë përmbushur kushtet për mbrojtje të detyruar.²⁴ Siç tregon edhe grafiku i mëposhtëm, në vetëm 11 nga këto shqyrtime është caktuar mbrojtësi sipas detyrës zyrtare. Në 137 shqyrtime gjyqësore nuk është caktuar mbrojtësi dhe rrjedhimisht të pandehurit mbetën të pa-

dhe nga ngritja e aktakuzës, nëse aktakuza është ngritur kundër të pandehurit për veprë penale për të cilën parashihet dënim prej së paku 10 vjet burg.


²¹ Neni 58 KPP. Kjo pasqyron formulimin e përdorur në nenin 14(3)(d) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe politike: në përcaktimin e çfarëdo akuze penale kundër tij/saj, çdo njëri do të ketë të drejtë të gëzojë mbrojtje ligjore që i caktohet atij/asaj, në çdo rast ku interesi i drejtësisë e kërkon këtë dhe atë pa pagesë nga ai/ajo në raste kur ai/ajo nuk mund ta përballojë financiarisht. Paragrafi (1.1) i nenit 58 KPP gjithashtu thekson se mbrojtësi caktohet me shpenzime publike për të pandehurin me kërkesë të këtij/kësaj të fundit nëse nuk ka kushte për mbrojtje të detyruar dhe kur procedurat penale zhvillohen për veprë penale që dënueshme me 8 vjet apo më shumë.

²² Neni 74, KPPP.


²³ *Quaranta v Switzerland*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 24 majit 1991, paragrafët 33-34. Shih Standardet Evropiane dhe Ndërkombëtare për të Drejtën në Ndihmë Ligjore, Iniciative e Drejtësisë e Shoqërisë së Hapur, dhjetor 2014, <https://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/international-minimum-standards-right-legal-aid-English-20150210.pdf>) dhe Sigurimi i së Drejtës në Avokat Mbrojtës, OSBE Misioni në Shkup, (dhjetor 2010), <http://www.osce.org/skopje/77774>, f. 45 “Shprehja ‘në interes të drejtësisë’ e përdorur në nenin 70 të LPP ka krijuar ndjenja të përziera në mesin e të anketuarve – disa mendojnë që paqartësia e shprehjes lejon shumë hapësirë për interpretim. Është e rëndësishme të theksohet që LPP i ri ka një formulim të ngjashëm me atë të Konventës Evropiane dhe jurisprudencës së saj përkitazi me mbrojtjen e kërkuar. Dispozita që flet për avokatin apo mbrojtësin e caktuar nga gjykata të pandehurve në nevojë në raste kur mbrojtja e detyruar nuk është zbatueshme duhet të qartësohet për t'i kënaqur kërkesat e diktuar nga interesi i drejtësisë, sipas kësaj Konvente.”

²⁴ Shih nenin 246(2) KPP. Kjo dispozitë kërkon që gjyqtari, gjatë shqyrtimit fillestar, të bindet që e drejta e të pandehurit për mbrojtës është respektuar. Prandaj, statistikat e treguara këtu sigurojnë informacione për numrin e shqyrtimeve fillestare ku avokati me shpenzime publike është caktuar për të pandehurin sipas nenit 58 të KPP.

përfaqësuar. Në 68 shqyrtimet gjyqësore të mbetura, të pandehurit vendosën të angazhojnë avokat mbrojtës me shpenzime të tyre.



Në mënyrë të ngjashme, u monitoruan 192 shqyrtime fillestare produktive në departamentin e krimeve të rënda. Në 96 të këtyre shqyrtimeve, kushtet për mbrojtjen e detyruar nuk ishin përmbushur. Këtu përfshiheshin dhe shqyrtimet e mbajtura për çështje penale të mashtrimit në zgjedhje që janë në kompetencë të departamentit për krime të rënda që nga janari i vitit 2013, por që janë të dënueshme me dënime me burgim relativisht të shkurtër.²⁵ Siç është paraqitur në grafikun e mëposhtëm, të pandehurit iu caktua mbrojtës sipas nenit 58 të KPP-së në vetëm 8 nga këto shqyrtime. Në 70 shqyrtime tjera, të pandehurit nuk kishin mbrojtës, ndërsa në 18 rastet e tjera të pandehurit zgjodhën që të merrnin një mbrojtës me shpenzimet e tyre.



²⁵ Vlen të ceket se janë monitoruar 22 raste të mashtrimit në zgjedhje pranë Departamentit për Krime të Rënda, dhe atë jo vetëm shqyrtimet fillestare por edhe shqyrtimet kryesore. Në 12 sosh, të pandehurit nuk ishin të përfaqësuar nga avokati.

Kjo gjetje vërtetohet dhe nga përgjigjet në pyetësorët që u janë shpërndarë avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjashtëdhjetë e shtatë për qind e avokatëve të cilët i kanë plotësuar pyetësorët janë përgjigjur të kenë qenë të caktuar “rrallëherë ose asnjëherë” si mbrojtës me shpenzime publike për ta përfaqësuar ndonjë të pandehur në rastet kur mbrojtja nuk është e detyrueshme. Gjithsej 58 për qind e prokurorëve janë deklaruar të kenë qenë përfshirë “rrallëherë ose asnjëherë” në çështje të këtilla ku të pandehurit i është caktuar mbrojtës me shpenzime publike. Në fund, vetëm 10 për qind e gjyqtarëve të cilët iu janë përgjigjur pyetësorëve kanë deklaruar të kenë caktuar “shpesh” mbrojtës me shpenzime publike në rastet kur mbrojtja nuk ka qenë e detyrueshme.

Sipas nenit 246(1) të KPP-së, në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për ndihmë juridike. Megjithatë, në praktikë, gjyqtarët nuk e informojnë zakonisht në mënyrë të duhur të pandehurin për të drejtën e tij ose të saj për të pasur mbrojtës me shpenzime publike në rastet kur nuk plotësohen kushtet për mbrojtje të detyrueshme. Nga 408 shqyrtime fillestare produktive para departamentit të përgjithshëm apo atij për krime të rënda që janë monitoruar në të cilat nuk janë përmbushur kushtet për mbrojtje të detyrueshme, gjyqtarët e kanë informuar në mënyrë të rregullt të pandehurin për të drejtën e tij për mbrojtje me shpenzime publike në vetëm 31 sosh. Në përgjithësi, gjyqtarët i kanë lexuar thjesht të drejtat e parapara me nenin 246(1) të KPP-së, duke përfshirë të drejtën e të pandehurit që “të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike”, por nuk i kanë sqaruar këto të drejta. Gjithashtu, gjatë shqyrtimeve që janë monitoruar është vërejtur se gjyqtarët kanë shtuar nganjëherë në mënyrë të nënkuptuar se, meqë nuk janë përmbushur kushtet për mbrojtje të detyrueshme, të pandehurit duhet ta paguajnë vetë avokatin nëse dëshirojnë të kenë një të tillë.²⁶ Në aktgjykimin e datës 1 shkurt 2015, Gjykata Supreme ka konstatuar se nuk mjafton që gjyqtari i çështjes vetëm ta përmend të drejtën për ndihmë juridike kur e udhëzon të pandehurin për të drejtat e tij. Ai ose ajo duhet të pyetet nëse dëshiron të angazhojë mbrojtës privatisht, të paraqesë kërkesë për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, apo të heqë dorë nga e drejta e tij në mbrojtje sipas nenit 53 të KPP-së.²⁷

OSBE-ja i ka monitoruar 21 vendime të nxjerra sipas nenit 58 të KPP-së. Shumica nga to nuk kanë qenë të arsyetuara sa duhet.²⁸ Gjykata nuk e ka zbatuar testin e dyfishtë të paraparë me nenin 58 të KPP-së në asnjërën nga çështjet ku të pandehurit i është caktuar mbrojtës. Për shembull, në disa raste gjykata ka vendosur se është “në interes të drejtësisë” që të pandehurit t’i caktohet mbrojtës me shpenzime publike, pa e verifikuar gjendjen pasurore të të pandehurit. Në rastet e tjera, gjykata ka caktuar mbrojtës mbi bazën se i pandehuri nuk mund t’i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij, por nuk ka verifikuar nëse këtë e kërkon “interesi i drejtësisë”. I dobët po ashtu ka qenë dhe arsyetimi se përse caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike kërkohet për “interes të drejtësisë”. Për shembull, disa çështje janë cilësuar si komplekse por nuk janë dhënë arsyet për këtë. Mungesa e arsyetimit është madje edhe më brengosëse në rastin e vendimeve për refuzim të kërkesës së të pandehurve për përfaqësim ligjor falas.

²⁶ Procesverbali i njëres nga shqyrtimet e monitoruara thotë: “Gjyqtari i vetëm gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën [...] për t’u mbrojtur vet ose për të angazhuar mbrojtës”, gjë që nënkupton se të pandehurit do t’i duhet t’i mbulojë vetë shpenzimet për mbrojtje.

²⁷ Aktgjykimin i Gjykatës Supreme Pml.nr.23/2015 i datës 1 shkurt 2015.

²⁸ OSBE-ja i ka shqyrtuar 21 vendime. Në 19 sosh është caktuar mbrojtësi me shpenzime publike, ndërsa në 2 vendime të tjera është refuzuar kërkesa e të pandehurit për përfaqësim ligjor falas. Nëntëmbëdhjetë prej këtyre vendimeve nuk kanë qenë të arsyetuara mjaftueshëm.

Sipas KPP-së, këto aktvendime mund të ankimohen. Megjithatë, arsyetimi i mangët i dhënë nga gjykata u pamundëson të pandehurve që të përcaktojnë nëse ka apo nuk ka bazë për të paraqitur ankesë.²⁹ Në fund, vlen të ceket se që të 21 aktvendimet që i ka shqyrtuar OSBE-ja janë dhënë gojarisht. Gjersa neni 58 i KPP-së nuk parasheh shprehimisht që këto aktvendime të jepen me shkrim, gjyqtarët janë përgjithësisht të detyruar që të nxjerrin vendime të arsyetuara mirë për të dëshmuar se janë dëgjuar palët, për t'ju dhënë atyre mundësinë që ta ankimojnë vendimin, si dhe mundësinë e rishikimit të atij vendimi nga organi i apelit, dhe për të siguruar përfundimisht mbikëqyrjen publike të administrimit të drejtësisë.³⁰


Sa i përket kërkesës së re të paraparë me KPP për plotësimin e një deklaratë nga i pandehuri para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike, OSBE-ja ka vënë re se kjo nuk është bërë në asnjërin nga rastet e monitoruara ku është caktuar mbrojtësi. Në përgjigjet e tyre në pyetësorët, avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët kanë qenë po ashtu në përgjithësi të pajtimit se i pandehuri nuk e ka plotësuar deklaratën e nevojshme në rastet kur i është caktuar mbrojtës me shpenzime publike.

3.1.2. Ndikimi i mospërfaqësimit të të pandehurit në sistemin akuzator

Sipas KPP-së, siç sqarohet më hollësisht në vijim, përgjegjësitë e mbrojtjes në procedurë janë rritur në masë të konsiderueshme. Tani, roli i mbrojtjes është që ta vë në dyshim cilësinë e provave që janë paraqitur nga prokuroria, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të qëndrimit të të pandehurit. Të pandehurit pa mbrojtës, të cilët kanë pak të ngjarë të kenë përgatitje në lëmin e juridikut apo përvojë praktikë në gjykata penale, nuk janë në gjendje që t'i plotësojnë këto përgjegjësi të reja të shtuara. Për shembull, vetëm 11 për qind e prokurorëve, përkatësisht 4 për qind e gjyqtarëve të cilët e kanë plotësuar pyetësorin kanë deklaruar të kenë qenë “shpesh” të përfshirë në çështje ku i pandehuri i cili nuk ka pasur mbrojtës ka paraqitur propozim për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe/ose ka kundërshtuar provat përpara shqyrtimit të dytë. Gjithashtu, OSBE-ja i ka monitoruar 111 shqyrtime të dyta produktive të mbajtura para departamentit të përgjithshëm dhe atij për krime të rënda. Në 34 sosh, të pandehurit nuk kishin mbrojtës. Shtatë syresh vendosën të pranonin fajësinë gjatë shqyrtimit dhe, për rrjedhojë, nuk e kundërshtuan aktakuzën. Vetëm 5 nga 27 të pandehurit të cilët nuk e pranuan fajësinë paraqitën propozim për hedhjen poshtë të aktakuzës, ndërsa 22 të pandehurit e tjerë pa mbrojtës nuk e kundërshtuan aktakuzën, ndonëse në deklaratimet e tyre të pafajësisë është qartësuar se ata nuk e pranonin fajësinë për veprat për të cilat akuzoheshin dhe kështu nuk e pranonin përmbajtjen e aktakuzës së ngritur kundër tyre.

²⁹ Shih nenet 374 dhe 408 të KPP-së për ankesat kundër aktvendimeve të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues. Shih gjithashtu f. 210 të Buletinit Ligjor të ODIHR-it në lidhje me të drejtën për vendime të arsyetuara, *shënimi 11 i cekur më lart*.

³⁰ Shih *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 8 prillit 2004, para. 83.



Shqetësuese është po ashtu marrja në pyetje e të pandehurve pa mbrojtës të cilët dëshirojnë të dëshmojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose me fjalë tjera të japin dëshmi dhe t'i paraqesin faktet e provat e tyre. Neni 346 i KPP-së parasheh që, nëse i akuzuari zgjedh që të dëshmoj, mbrojtësi do ta bëjë marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje të të pandehurit, ndërsa prokurori marrjen e tërthortë në pyetje. Megjithatë, në shtatë çështje të shqyrtuara nga departamenti i përgjithshëm që i ka monitoruar OSBE-ja është vënë re se kur të pandehurit pa mbrojtës zgjedhën të deklarohen dhe të jepnin dëshmi sipas nenit 346 të KPP-së, duke qenë se nuk kishte mbrojtës që ta bënte marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje ata i mori së pari në pyetje prokurori dhe, si rrjedhojë, të pandehurit nuk patën mundësi të deklarojnë versionin e tyre të çështjes përmes marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje.³¹

Andaj, të gjendur në një pozitë të tillë, në përgjithësi, të pandehurit pa mbrojtës nuk mund ta bëjnë marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarëve të prokurorisë. Në shumë nga çështjet e monitoruara, të pandehurit pa mbrojtës kanë deklaruar të kenë pasur “kundërshtime ndaj deklaratave” të dëshmitarëve të prokurorisë ose provave materiale që i ka paraqitur prokuroria, por nuk u kanë bërë shtruar dëshmitarëve asnjë pyetje dhe për rrjedhojë nuk e kanë sfiduar cilësinë e provave të prokurorisë.³²

Siç u përmend më sipër, të pandehurit pa mbrojtës ndodhen shpesh në një pozitë shumë të pafavorshme në raport me prokurorin. Prandaj, është thelbësore që gjyqtari të ndërhyjë dhe të sigurojë barazinë e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas KPP-së, ndonëse roli i gjyqtarit është shndërruar nga një rol shumë proaktiv në një rol më pak aktiv gjatë procedurës, ai vazhdon të jetë “garantues i të drejtave” dhe ka detyrime të reja eksplicite për mbrojtjen e të drejtave të palëve.³³ Udhëzuesi për KPP-në po ashtu vë në dukje se procedura akuzatore nuk do të thotë që gjyqtari shërben vetëm si një gjykues pasiv, sepse ai mund të kërkojë

³¹ Neni 9(2) i KPP-së përcakton që i pandehuri ka të drejtë “të deklarohet për të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij”.

³² “Ende më shqetësuese është gjendja me të akuzuarit pa mbrojtës në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar” (shih Raportin e konsoliduar të KGJK-së, Shtojcën 5). Ky shqetësim është ngritur dhe gjatë punësive mbi zbatimin e KPP-së që janë mbajtur më 29 shtator dhe 20 tetor 2014 në Prishtinë/Priština.

³³ Udhëzuesi për KPP-në, f. 27.

informacione shtesë pasi prokurori dhe mbrojtja të kenë prezantuar rastet e tyre.³⁴ Me fjalë tjera, gjyqtarët duhet të jenë më aktivë në rastet kur i pandehuri nuk ka mbrojtës seç do të duhej të ishin zakonisht në një procedurë akuzatore.³⁵ Kështu, nëse për shembull i pandehuri pa mbrojtës nuk paraqet propozimin për hedhjen poshtë të aktakuzës ndërmjet shqyrtimit fillestar dhe të dytë, gjyqtari duhet të marrë vendim sipas detyrës zyrtare për të shqyrtuar nëse ka prova të mjaftueshme në aktakuzë për të proceduar me gjykim.³⁶ Në mënyrë të ngjashme, nëse i pandehuri pa mbrojtës dëshiron të dëshmoj gjatë gjykimit, gjyqtari duhet të sigurojë që ai të ketë mundësi për ta treguar versionin e vet të ngjarjeve përmes marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje.³⁷ Por, siç shtjellohet më hollësisht në Pjesën 3.5 më poshtë, ky raport ka gjetur se në praktikë gjyqtarët nuk e kryejnë shpesh në mënyrën e duhur këtë rol të garantuesit të të drejtave të palëve.

3.2. Roli i ri i mbrojtjes

Procedura penale sipas KPP-së tani është kryesisht akuzatore dhe rolet e pjesëmarrësve në procedurë penale kanë ndryshuar dukshëm.³⁸ Sipas kodit të mëparshëm, mbrojtja kishte rol të kufizuar ngaqë gjyqtari ishte i angazhuar aktivisht në mbledhjen e provave gjatë fazës së hetimit dhe paraqitjen e provave gjatë gjykimit. Sipas KPP-së, roli i gjyqtari tani është më pasiv dhe, si rrjedhojë, janë rritur përgjegjësitë e mbrojtësit, duke përfshirë këtu për vënien në kontestimin e cilësisë së provave të paraqitura nga prokuroria, si edhe paraqitjen e provave në mbështetje të qëndrimit të të pandehurit, siç janë alibia apo provat që kontestojnë motivin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale.³⁹

Nënpjesët e mëposhtme shtjellojnë se a po i përmbushë në mënyrën e duhur mbrojtja ca prej përgjegjësive të saj të reja sikurse: mbledhja e provave shfajësuese dhe kundërshtimi i përzgjedhjes së ekspertëve nga prokuroria në fazën e hetimit; zbulimi i dëshmive për prokurorinë dhe kundërshtimi i aktakuzës në fazën e aktakuzës; dhe vënia në pikëpyetje e provave të prokurorisë përmes marrjes së tërthortë në pyetje gjatë gjykimit.

3.2.1. Kërkesat për marrjen e provave shfajësuese nëpërmjet prokurorisë

Sipas KPP-së, mbrojtja ka “mundësi më të madhe për të marrë apo për të ruajtur prova para ngritjes së aktakuzës” meqë neni 216 i KPP-së i jep të pandehurit të drejtën që të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen e provave që janë relevante për procedurën dhe kur ka arsyetim.⁴⁰

³⁴ Udhëzues për KPP-në, f.28.

³⁵ Shih, për shembull, Pro Se Criminal Trials and the Merging of Inquisitorial and Adversarial Systems of Justice, Sharon Finegan, Catholic University Law Review, 2009, në dispozicion tek <http://scholarship.laë.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3162&context=laëreview>.

³⁶ Neni 250(3) i KPP-së përcakton si vijon: “Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hudh aktakuzën”. Vlen të ceket që KPP-ja përcakton shprehimisht në nenin 249(5) KPP Të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se provat janë të papranueshme. Shih po ashtu dhe Udhëzues për KPP-në, f. 27.

³⁷ Neni 346(7) i KPP-së nuk përshkruan shprehimisht se në c ‘mënyre duhet të bëhet marrja në pyetje e të pandehurit pa mbrojtës, mirëpo i lejon qartazi gjyqtarit që t’i shtrojë pyetje të pandehurit kur të jetë e nevojshme.

³⁸ Udhëzues për KPP-në, f. 13: sipas kodit të mëhershëm, procedura përshkruhej si “kuazi-akuzatore” apo “hibride”.

³⁹ Udhëzues për KPP-në, f. 27-30.

⁴⁰ Udhëzuesi për KPP-në, f.58. Shih gjithashtu dhe Komentari i Kodit të procedurës penale të Kosovës nga Ejup Sahiti, Rexhep Murati dhe Xhevdet Elshani, të botuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale

Ai arsyetim mund të përfshijë rrezikun që provat mund të humbasin apo të mos jenë në dispozicion në kohën e gjykimit, që mund ta arsyetojnë lirimin e të pandehurit nga paraburgimi, apo nëse ekzistojnë gjasa të arsyeshme që ato do të jenë shfajësuese. Udhëzuesi për KPP nënvizon që “kjo është fazë kritike për të pandehurin në mënyrë që ai të ketë qëndrim më kritik gjatë gjykimit” duke qenë se kjo është faza në të cilën merren shumica e provave.

Nëse prokurori i shtetit e refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr aktvendim të arsyetuar dhe e njofton të pandehurin. I pandehuri mund të ankohet te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj aktvendimit të tillë.⁴¹ Një nen i ngjashëm ka qenë dhe në kodin e mëparshëm të procedurës penale.⁴² Megjithatë, mundësia e të pandehurit për të marrë prova nëpërmjet prokurorisë është zgjeruar me KPP-në, sepse i pandehuri tani mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të merr po ashtu edhe prova që gjenden jashtë Kosovës.⁴³ Këto dispozita të reja i japin të pandehurit mundësi për të mbledhur prova që janë të barabarta me ato të prokurorit.⁴⁴

Megjithatë, në praktikë rrallëherë ndodhë që mbrojtja të paraqesë kërkesë te prokurori për mbledhjen e provave. Ndonëse 75 për qind e avokatëve të cilët u janë përgjigjur pyetjeve në pyetësor kanë thënë se i paraqesin kërkesë prokurorit “kohë pas kohe” ose “shpesh”, 78 për qind e prokurorëve kanë thënë se pranojnë “rrallëherë ose asnjëherë” kërkesa të tilla nga mbrojtja, dhe pothuajse gjithë gjyqtarët kanë thënë se marrin “rrallëherë ose asnjëherë” ankesa nga mbrojtja kundër vendimeve për refuzimin e këtyre kërkesave. Gjatë intervistave të realizuara gjatë tërë periudhës së raportimit, disa prokurorë kanë sqaruar se çështja e kërkesave të mbrojtjes për marrjen e provave shfajësuese shqyrtohet kur i pandehuri ftohet nga prokuroria për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake. Kështu që të shumtën e kohës mbrojtja i bën kërkesat gojarisht, dhe vendimet e prokurorëve për refuzimin ose aprovimin e kërkesave të tilla bëhen gojarisht po ashtu, ose prokurorët thjesht i injorojnë ato. Në rrethana të tilla, mbrojtja e ka të vështirë që ta ushtrojë të drejtën për ankesë meqë nuk nxirren vendime me arsyetim.

Sipas KPP-së së ri, përveçse në fazën e procedurës paraprake, tani mbrojtja mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të paraqesë kërkesë për ekspertizë që është relevante për mbrojtjen edhe në fazën e hetimit.⁴⁵ Sipas Kodit të mëparshëm të procedurës penale, një gjë e tillë nuk mund të bëhej. Ekspertizën mund ta urdhëronte vetëm gjykata.⁴⁶ Nëse prokurori e refuzon kërkesën e mbrojtjes për ekspertizë, mbrojtja mund të paraqesë ankesë kundër këtij vendimi tek gjyqtari i procedurës paraprake.⁴⁷ Sipas Udhëzuesit për KPP-në, këto dispozita i japin të pandehurit “mundësi të barabartë për të kërkuar që provat të analizohen nga një ekspert”.⁴⁸

Megjithatë, në praktikë mbrojtja kërkon rrallëherë nga prokurori që të bëhet ekspertizë në fazën e hetimit. Vetëm tetë për qind e avokatëve të cilët i janë përgjigjur pyetësorit kanë

Zusammenarbeit (GIZ)-i në dhjetor të viti 2014 (“Komentari i KPP”), f. 545 (duhet të përcaktohen si rrethanat fajësuese ashtu edhe ato shfajësuese. i pandehuri dhe/ose mbrojtësi i tij, para dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, duhet të jenë në gjendje që t’i përdorin të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të të pandehurit).

⁴¹ Neni 216(4) i KPP.

⁴² Neni 239 i KPPP.

⁴³ Neni 216(3) i KPPP.

⁴⁴ Udhëzues për KPP-në, f. 14 (barazia e palëve).

⁴⁵ Neni 141(1) i KPP-së. I pandehuri mund të merr dhe të paguajë vetë për ekspertizë (Neni 141(2) i KPP).

⁴⁶ Neni 176 i KPPP-së.

⁴⁷ Neni 141(1) i KPP-së.

⁴⁸ Udhëzues për KPP-në, f. 13.

thënë se i paraqesin “shpesh” kërkesa të tilla prokurorit, dhe 90 për qind e prokurorëve kanë thënë se pranojnë kërkesa të tilla nga mbrojtja “rrallëherë ose fare”. Në fund, 87 për qind e gjyqtarëve kanë thënë se pranojnë “rrallëherë ose fare” ankesa kundër vendimeve për refuzimin e kërkesave të tilla për ekspertizë. Arsyeja e mosparaqitjes së ankesave nga mbrojtja është e njëjtë me atë që u sqarua më sipër: kërkesat e mbrojtjes për ekspertizë bëhen përgjithësisht gojarisht dhe vendimet e prokurorit për këto kërkesa jepen po ashtu gojarisht, ose prokurori nuk nxjerr vendim fare.

Dështimi i përgjithshëm i mbrojtjes për t’i shfrytëzuar mundësitë e reja të parapara me KPP për marrjen e provave shfajësuese në fazën e hetimit nëpërmjet prokurorisë dëshmohej po ashtu dhe nga fakti që mbrojtja nuk e dorëzon pothuajse kurrë njoftimin për emrat e dëshmitarëve të mbrojtjes në shqyrtim të dytë, kur dhe duhet ta bëjë një gjë të tillë, po parapëlqen zakonisht që të presë deri në shqyrtimin kryesor për të kërkuar provat, nëse ka të tilla (shih më poshtë 3.2.3). Vlen të ceket se një nga përfundimet në Raportin e konsoliduar të KGJK-së është që janë gjykatat ato që vazhdojnë ta bëjnë mbledhjen e provave në vend se këtë ta bëjnë palët, megjithëse Kodi i ri u jep atyre mundësi më të mëdha për ta bërë këtë.⁴⁹

Ky dështim për përgatitjen efikase të çështjes në fazën e hetimit është shumë brengosës. Forma akuzatore e procedurës penale ka në themel rolin aktiv të palëve në mbledhjen dhe paraqitjen e provave. Kjo formë e procedurës mund të realizohet me sukses vetëm në qoftë se palët përgatiten për gjykimin në kuptimin e mirëfilltë.⁵⁰ Në veçanti, roli i mbrojtjes është që t’i paraqesë gjykatës shpjegime alternative të besueshme të asaj çfarë ka ndodhur në ditën kritike dhe të ngjallë dyshime rreth shpjegimit të dhënë nga prokuroria. Për këtë qëllim, mbrojtja duhet “të vlerësojë nëse duhet kërkuar mbledhja e provave të cilat mbështesin pafajësinë e të pandehurit, siç mund të jenë alibitë apo provat të cilat tregojnë se i pandehuri nuk ka pasur motiv për të kryer veprën.”⁵¹ Për rrjedhojë, përgatitja e plotë para gjykimit është thelbësore: “Avokati së pari duhet ta shqyrtojë materialin në dispozicion, të takohet me palën e akuzuar/palën e dëmtuar dhe me të gjithë dëshmitarët përkatës, dhe në fund të këmbëjë ide në lidhje me lëndën me kolegët dhe hetuesit e tjerë. Avokati duhet patjetër t’i analizojë të gjitha informatat duke i pasur parasysh mospërputhjet dhe zbrazëtirat në lëndën e palës kundërshtarë [...] Të gjitha sferat dhe teoritë e mundshme duhet të vërehen dhe analizohen. Duhet të merret në konsideratë dëshmia e çdo dëshmitari të mundshëm. Çështjet e lidhura me provat duhet identifikuar [...] Duhet përcaktuar parametra për detyrat hetimore. Duhet organizuar një vizitë në vendin e ngjarjes dhe duhen shqyrtuar provat materiale.”⁵² Në fund, fakti që prokurorët nuk e konsiderojnë si të nevojshme nxjerrjen e vendimeve të arsyetuara me kërkesë të mbrojtjes për dëshmitë shfajësuese flet po ashtu për moskuptimin e qëllimit të këtyre dispozitave të rëndësishme në KPP.

⁴⁹ Raporti i Konsoliduar i KGJK-së (shënimi 9 më lart) f.2 “Edhe pse Kodi i ri u siguron palëve në procedurë më shumë mundësi për prezantimin e provave të tyre, kjo zbatohet me vështirësi në praktikë. Janë gjykatat përsëri ato që shpesh e bëjnë mbledhjen e provave” (f. 2). Shih po ashtu edhe f.4: “Të dyja palët, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të marrin rol më aktiv gjatë propozimit të dëshmiave në fazat më të hershme të shqyrtimit gjyqësor” dhe Shtojcën 3 (përfundimet nga punëtoritë në Pejë/Pec): “Janë gjykatat përsëri ato që përfundojnë në mbledhjen e provave pasi që palët nuk e bëjnë atë”.

⁵⁰ Publikim i Misionit të OSBE-së në Shkup, *Sigurimi i të drejtës për mbrojtës ligjor*, f.13, shënimi 24 më lart.

⁵¹ Udhëzues për KPP-në, f. 34.

⁵² Publikim i Misionit të OSBE-së në Shkup, *Marrja e tërthortë në pyetje, Doracak për profesionistët*, (dhjetor 2010), <http://www.osce.org/skopje/78064>, f. 70 (Udhëzime për marrja e tërthortë në pyetje nga Michael G. Karnavas).

3.2.2. Kundërshtimi i ekspertëve të përzgjedhur nga prokuroria

Sipas KPP-së, një prej kompetencave të reja të prokurorit është angazhimi i ekspertit gjatë fazës së hetimit pa qenë nevoja për t'i paraqitur propozim gjykatës.⁵³ Më pas, mbrojtja mund të kundërshtojë përzgjedhjen e ekspertit bazuar në kualifikimet e tij apo konfliktin potencial të interesit duke paraqitur kundërshtim tek gjyqtari i procedurës paraprake.⁵⁴ Kjo nënkupton se prokurori ka detyrimin për ta informuar mbrojtjen për vendimin e tij për të angazhuar ekspert, ndonëse dispozita përkatëse e KPP-së nuk parasheh shprehimisht që prokurori t'ia dërgojë vendimin mbrojtjes, ngaqë mbrojtja nuk do të mund ta ushtronte të drejtën për të kundërshtuar përzgjedhjen e ekspertit nga prokuroria në qoftë se prokuroria nuk do ta informonte atë për një vendim të tillë. Udhëzuesi për KPP-në sqaron se dhënia e mundësisë të pandehurit për të kundërshtuar përzgjedhjen e ekspertit është bërë me qëllim të balancimit me faktin që, sipas KPP-së, tani prokurori mund të angazhojë ekspertin gjatë fazës së hetimit pa pasur nevojë që t'i paraqesë për këtë kërkesë gjykatës. Ky “balancim” ka qenë njëri nga parimet udhëheqëse të hartuesve të KPP-së: “Në çdo rast kur është bërë ndonjë ndryshim që ka rezultuar në zgjerimin e kompetencave të njëres palë, është bërë edhe ndryshimi tjetër për të balancuar ato kompetenca”.⁵⁵

Në praktikë, mbrojtja rrallëherë e kundërshton përzgjedhjen e ekspertit të angazhuar nga prokuroria. Gati të gjithë prokurorët, të cilët janë përgjigjur në pyetësor, deklaruan se mbrojtja “rrallëherë ose asnjëherë” nuk e sfidon përzgjedhjen e ekspertëve nga ana e tyre sipas nenit 137(1) të KPP duke paraqitur kundërshtim pranë gjyqtarit të procedurës paraprake. Për më tepër, 92 për qind e gjyqtarëve konfirmuan se ata “rrallëherë ose asnjëherë” nuk pranojnë kundërshtime të tilla. Fakti që mbrojtja gati asnjëherë nuk paraqet kundërshtime të tilla gjithashtu ngre dyshime se prokuroria nuk e njofton gjithmonë mbrojtjen mbi vendimin për emërimin e ekspertëve. Në të vërtetë, afërsisht 40 për qind e avokatëve, të cilët janë përgjigjur në pyetësor, deklaruan se ata nuk janë njoftuar për vendimet e prokurorëve për emërimin e ekspertit.⁵⁶ Kjo informatë është vërtetuar gjatë disa intervistave me avokatët.⁵⁷ Njëri prej tyre nënvizoi se prokurorët në përgjithësi jo vetëm që nuk ia japin atij këto vendime, por edhe se nuk i sigurojnë asnjë lloj dokumentacioni. Ai duhet të shkojë në zyrën e prokurorisë dhe të mbledhë dokumentacionin. Ky shqetësim është ngritur edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në raportin e konsoliduar, ku ceket se “në praktikë është e vështirë të sigurohet barazia e armëve [...] prokurorët shpeshherë nuk arrijnë t'u sigurojnë mbrojtësve qasje të pakufizuar në shkresat e lëndës”.⁵⁸

⁵³ Sipas PKPPK-së së mëparshëm, neni 176, ekspertiza duhehet të urdhërohet me shkrim nga gjykata me kërkesë të prokurorit publik. Sipas KPP të ri, prokurori nxjerr thjesht një vendim që i plotëson kërkesat minimale të përcaktuara me nenin 137(1) të KPP. Shih po ashtu Komentarin e KPP-së (*shënimi 41 më lartë*) p. 380 (Gjykata nuk “e sponsorizon” më emërimin e ekspertit).

⁵⁴ Neni 137(1) i KPP.

⁵⁵ Udhëzuesi për KPP-në, Kontrolli dhe bilanci, f. 17.

⁵⁶ Në përgjithësi është e vështirë që të monitorohet nëse prokurorët kanë përbushur detyrimin për ta njoftuar mbrojtjen (dhe palën e dëmtuar) për vendimet e tyre për emërimin e ekspertit, siç përcaktohet shprehimisht me nenin 137(2) të KPP, për shkak se kjo ndodh gjatë fazës së hetimit mes palëve dhe jo gjatë seancave publike. Për të njëjtat arsye, është e vështirë që të monitorohet nëse prokurorët kanë përbushur detyrimin e tyre për t'ia siguruar mbrojtjes (dhe palës së dëmtuar) raportin e ekspertit jo me vonë se dhjetë ditë pas pranimit të tij, siç përcaktohet me nenin 138(5) të KPP.

⁵⁷ Shtatë avokatë nga rajone të ndryshme në Kosovë u intervistuan për këtë çështje gjatë periudhës së raportimit.

⁵⁸ Raport i konsoliduar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*shënimi 9 më lart*) Shtojca2.

3.2.3. Detyrimi i zbulimit të provave

Në fazën e hetimeve, mbrojtja mbledhë provat që i nevojiten për t'i paraqitur në gjykim për rastin e saj. Pastaj, në shqyrtim të dytë, mbrojtja ka detyrim që t'ia paraqet prokurorit njoftimin me emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar në gjykim.⁵⁹ Gjyqtari siguron se mbrojtja e ka përmbushur këtë detyrim gjatë shqyrtimit të dytë.⁶⁰ Nëse mbrojtja nuk e përmbush detyrimin për ta bërë një gjë të tillë, gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në 250 euro ndaj avokatit mbrojtës.⁶¹ Dëshmitarët e mbrojtjes më pas thirren në shqyrtim gjyqësor⁶² dhe në fillim të seancës gjykata cakton radhën e marrjes në pyetje sipas së cilës do të thirren dëshmitarët e propozuar nga palët.⁶³

Në praktikë, megjithatë, mbrojtja shpesh nuk ia paraqet prokurorisë në shqyrtim të dytë njoftimin e përcaktuar me emrat e dëshmitarëve të mbrojtjes. OSBE-ja ka monitoruar 111 shqyrtime të dyta efektive në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda. Kur të pandehurit nuk e pranonin fajësinë, mbrojtja nuk e paraqiste njoftimin e përcaktuar. Ajo e bëri një gjë të tillë vetëm në pesë shqyrtime që u monitoruan. Për më tepër, në asnjë nga shqyrtimet që u monitoruan, ku mbrojtja nuk e paraqiti njoftimin e përcaktuar, nuk u shqiptua gjoba. Përfundimisht, nuk ka praktikë të standardizuar gjyqësore përkitazi me shqyrtimin e dytë; shpesh ndodhë që këto shqyrtime të mos mbahen.⁶⁴ Prandaj, gjyqtarët nuk e kanë mundësinë për të vërtetuar nëse mbrojtja e ka përmbushur detyrimin e njoftimit nga ana e saj.

Përgjigjet e dhëna në pyetësor nga gjyqtarët, avokatët dhe prokurorët konfirmojnë këtë dështim të përgjithshëm nga ana e mbrojtjes për ta paraqitur njoftimin e përcaktuar. Vetëm 32 për qind e avokatëve, të cilët u përgjigjën në pyetësor, deklaruan se “shpesh” e paraqesin njoftimin gjatë shqyrtimit të dytë. Për më tepër, vetëm 12 për qind e prokurorëve u përgjigjën se mbrojtja “shpesh” u paraqet atyre këto njoftime dhe gjashtë për qind e gjyqtarëve u përgjigjën se mbrojtja “shpesh” i paraqet njoftimet.

Siç shpjegohet më sipër, mbrojtja gati kurrë nuk e paraqet njoftimin me emrat e dëshmitarëve të mbrojtjes gjatë shqyrtimit të dytë, dhe në vend të kësaj zakonisht parapëlqejnë që të presin deri në shqyrtim gjyqësor për t'i paraqitur provat. Kjo praktikë është e papërshtatshme në sistemin akuzator. Mbrojtja duhet ta dijë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor se nga çka do të përbëhet rasti i mbrojtjes dhe duhet, ndër të tjera, të përgatit fjalën hyrëse që do t'i ndihmojë gjykatës që ta kuptojë se si po i kundërshton provat. Udhëzuesi për KPP shpjegon se “edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 288 të KPP palët mund të kërkojnë që të thirren dëshmitarë të rinj. Kjo u garanton palëve të drejtën për proces të rregullt, por ajo nuk mund të keqpërdoret sepse kërkesa duhet të mbështetet në arsyetim dhe duhet të saktësojë provat që do të merren.”⁶⁵ Ajo çka është edhe më shqetësuese është se në disa raste, jo vetëm pranë Departamentit të Përgjithshëm, por edhe pranë Departamentit për Krime të Rënda, mbrojtja vendos që të mos paraqes asnjë lloj prove ndonëse të pandehurit nuk e

⁵⁹ Neni 256 i KPP.

⁶⁰ Neni 254(2) i KPP.

⁶¹ Neni 256(3) i KPP. Dispozita të ngjashme kanë ekzistuar në kodin e mëparshëm (neni 308 i KPPP).

⁶² Neni 287(1) i KPP.

⁶³ Neni 331(1) i KPP.

⁶⁴ Në një nga konstatimet e raportit të konsoliduar të KGJK thuhet si në vijim: “nuk ekziston një praktikë e vetme mes gjyqtarëve rreth shqyrtimit fillestar dhe atij të dytë”, f. 2.

⁶⁵ Udhëzuesi për KPP, f. 65-66. Shih po ashtu komentari për KPP, f. 746 (ku përcaktohet se provat e reja nuk duhet të keqpërdoren) dhe f. 665 (njoftimi i prokurorisë me provat zvogëlon mundësinë e zgjatjes së procedurave gjatë shqyrtimit gjyqësor).

pranuan fajësinë. Kjo gjithashtu e shpjegon atë se përse mbrojtja në këto raste nuk e paraqet njoftimin me emrat e dëshmitarëve gjatë shqyrtimit të dytë.⁶⁶ Këto raste janë shembuj konkret për dështimin e përgjithshëm nga ana e mbrojtjes për të marrë përsipër përgjegjësitë e saja të reja të përcaktuara me Kodin e ri të Procedurës Penale.

3.2.4. Kundërshtimi i aktakuzës

Udhëzuesi për KPP shpjegon se prokuroria dhe mbrojtja janë në pozitë të barabartë, të dyja duke luajtur një rol njësoj të rëndësishëm, gjatë shqyrtimit të parë dhe të dytë e që është “një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm në këtë proces”.⁶⁷ Sipas nenit 250 të KPP, mbrojtja gëzon të drejtën që të paraqes kërkesë në gjykatë për hedhjen e aktakuzës nëse konsideron se aktakuza nuk mbështetet në një dyshim të bazuar mirë.⁶⁸

Në praktikë, megjithatë, shumë kërkesa të paraqitura nga mbrojtja ishin të cilësisë së dobët. Në 24 kërkesa, të cilat u grumbulluan dhe shqyrtuan nga OSBE-ja e që ishin paraqitur pranë Departamentit të Krimeve të Rënda, mbrojtja kryesisht argumentonte se prokurori nuk ka mbledhur prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale. Udhëzuesi për KPP këshillon që nuk duhet të paraqiten argumente të tilla si rutinë për shkak “se rrit rrezikun që gjyqtari të merr vendim për refuzimin e kërkesës dhe të gjejë se aktakuza, nëse provohet, ajo me të vërtetë ta mbështet dyshimin e bazuar mirë. Pranimi i një vendimi të tillë mund të nxisë mbrojtjen që të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 233”.⁶⁹

3.2.5. Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarëve

Kur një palë paraqet provat, pala e cila e propozon provën e merr në pyetje dëshmitarin ose paraqet provën e para.⁷⁰ Palëve të tjera pastaj u jepet mundësia për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit ose për të kundërshtuar besueshmërinë e dëshmitarit.⁷¹ Kodi i mëparshëm i procedurës nuk ka përmbajtur dispozita të tilla për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Në kodin e mëparshëm të procedurës, nëse dëshmitarit ose ekspertit nuk i janë kujtuar faktet të cilat i ka paraqitur më parë gjatë marrjes në pyetje, ose kur ai a ajo i shmangej deklaramit të mëparshëm, kryetari i trupit gjykues ose palët mund t’ia tërhiqnin vërejtjen lidhur me deklaramin e mëparshëm dhe t’i kërkonin shpjegim përse tani dëshmon ndryshe. Sipas nevojës, kryetari i trupit gjykues lexonte deklaramin e tij të mëparshëm ose pjesë të atij deklarami.⁷²

Në praktikë megjithatë mbrojtja shpesh dështon që, përmes marrjes së tërthortë në pyetje, në mënyrë efikase të kundërshtojë provat që janë paraqitur nga prokuroria. Në shumë raste që u monitoruan u vërejt se avokatët po vazhdonin me marrjen në pyetje të dëshmitarëve në të

⁶⁶ OSBE-ja ka monitoruar 28 raste të tilla pranë Departamentit të Përgjithshëm dhe 17 pranë Departamentit për Krime të Rënda.

⁶⁷ Udhëzuesi për KPP, f. 13 dhe 57.

⁶⁸ “Dyshim i bazuar mirë” ishte gjithashtu standardi që është përdorur në kodin e mëparshëm. Sipas nenit 19 të KPP, “dyshimi i bazuar mirë” është posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri”. Ky standard duhet të dallohet nga standardet e tjera të tilla si “dyshim i arsyeshëm” dhe “përtej dyshimit të arsyeshëm”.

⁶⁹ Udhëzuesi për KPP, f. 58

⁷⁰ Neni 332 i KPP.

⁷¹ Neni 332(2) i KPP.

⁷² Neni 364 i KPPP.

njëjtën mënyrë siç janë mësuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale.⁷³ Ata i shtrojnë pyetje dëshmitarëve, por nuk e përdorin marrjen e tërthortë në pyetje si “vegël moderne gjyqi” që u mundëson atyre diskreditimin e dëshmive të dëshmitarëve të prokurorisë ose për të fuqizuar rastin e mbrojtjes.⁷⁴ Ata shpesh deklarojnë se kundërshtojnë dëshminë e dëshmitarit, por nuk japin arsye përse. Për më tepër, në shumë raste, gjykata vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit. Mbrojtja duket se është e paaftë për ta zhvilluar në mënyrë efikase marrjen e tërthortë në pyetje ose për shkak se nuk është e përgatitur mjaft, ose për shkak se i mungon përvoja për ta zhvilluar këtë lloj të marrjes në pyetje. Një nga konstatimet në raportin e konsoliduar të KGJK është se “teknikat e reja të marrjes në pyetje shpeshherë nuk zbatohen në mënyrë të duhur”. Më pas jepet rekomandimi që gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të aftësohen edhe më tej mbi teknikat e marrjes në pyetje e në veçanti të atyre mbi marrjen e tërthortë në pyetje.⁷⁵

Dështimi i përgjithshëm nga ana e mbrojtjes për të kundërshtuar në mënyrë efikase cilësinë e provave që paraqiten nga prokuroria, përmes marrjes së tërthortë në pyetje, tregon se mbrojtja përballet me vështirësi në përqafimin e rolit të saj të ri aktiv që përcaktohet me Kodin e ri të Procedurës Penale.

3.3.Roli i ri i prokurorisë

Dispozitat e reja të KPP e ngarkojnë prokurorin me përgjegjësi më të madhe për zhvillimin dhe paraqitjen e provave. Prokurori “prandaj duhet të mendojë për provat dhe, nëse është e nevojshme, të gjejë vërtetimet për provat që nuk janë edhe aq të besueshme, relevante dhe bindëse sa ai ose ajo do të dëshiron të ishin”.⁷⁶ Në pjesët si në vijim vlerësohet nëse prokuroria po i zbaton në mënyrë të duhur ose jo disa nga përgjegjësitë e saja të reja, të tilla si: marrja e dëshmisë së dëshmitarit gjatë intervistimit në procedurë paraprake dhe marrjes së dëshmisë në procedurë paraprake në fazën e hetimeve; paraqitja e mbështetjes së pohimit së bashku me aktakuzë kur provat duhet të vërtetohen dhe përdorimi i alternativave ndaj gjykimit kur është e përshtatshme, duke përfshirë negocimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë jo vetëm pas, por edhe para ngritjes së aktakuzës.

3.3.1. Deklaratat e dëshmitarit në procedurën paraprake: marrja në pyetje në procedurë paraprake dhe deklarata në procedurë paraprake

3.3.1.1.Dy lloje të reja të dëshmive të dëshmitarit

Sipas Udhëzuesit për KPP, një fushë që ka pësuar ndryshime thelbësore në procedurën penale janë hetimet në procedurën paraprake [...] Tani ka më shumë opsione për marrjen e dëshmisë nga dëshmitarët gjatë hetimeve: marrja në pyetje në procedurën paraprake, deklarata në procedurën paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë. Disa [opsione] ofrojnë më shumë mbrojtje sesa të tjerat dhe si pasojë [deklaratat e marra nga dëshmitarët] janë më të pranueshme në shqyrtim gjyqësor sesa të tjerat”.⁷⁷

⁷³ OSBE-ja ka monitoruar 51 shqyrtime gjyqësore në rastet pranë Departamentit për Krime të Rënda e gjatë së cilave mbrojtja ka zhvilluar marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të prokurorisë.

⁷⁴ Shih Udhëzuesin për KPP, f. 69.

⁷⁵ Raporti i konsoliduar i KGJK (shih shënimin 9 më lartë) f. 3–4.

⁷⁶ Udhëzuesi për KPP, f.27–30.

⁷⁷ Udhëzuesi për KPP, f.45.

Kodi i mëparshëm i procedurës nuk ka përmbajtur dispozita të veçanta që rregullonin mënyrën se si duhej të merreshin deklaratat e dëshmitarëve në procedurë paraprake.⁷⁸ Ai gjithashtu nuk përmbante dispozita të hollësishme që rregullonin mënyrën se si do të përdoreshin deklaratat e dëshmitarëve, të cilat ishin marrë në procedurë paraprake, në shqyrtim gjyqësor.⁷⁹ KPP tani përmban dispozita të sakta që rregullojnë mënyrën se si duhet të merren deklaratat e dëshmitarëve nga prokurorët gjatë fazës së hetimeve. Ekzistojnë tre lloje të seancave gjatë së cilave dëshmitë mund të merren nga dëshmitarët: marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë.⁸⁰ Ndonëse emërtimi ka ndryshuar paksa, në të vërtetë nuk ka dallime thelbësore mes mundësisë hetuese të veçantë dhe mundësisë hetuese të jashtëzakonshme në kodin e mëparshëm.⁸¹ Prandaj, vetëm dy llojet e para të seancave janë të reja. Në seancën e marrjes në pyetje në procedurë paraprake, prokurori mund të lejojë mbrojtësin, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të merr pjesë në marrjen në pyetje në procedurë paraprake, dhe marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të incizohet audio, të incizohet audio dhe video, të transkribohet fjalë për fjalë ose të përmbledhet në një raport.⁸² Ekzistojnë më shumë formalitete gjatë seancës në procedurë paraprake. Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopja e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës. Mospjesëmarrja e pajustificuar e të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave në seancën për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake, pasi të ketë pranuar njoftimin, ia mohon atij të pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuari apo mbrojtësi të viktimës që të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë në një fazë të mëvonshme të procedurës penale. Përfundimisht, nëse në procedurë penale hetohet vepra penale për të cilën parashihet dënimi maksimal me tre apo më shumë vjet burgim, deklarata në procedurë paraprake audio incizohet, video incizohet ose transkribohet.⁸³

Mënyra se si dëshmia e marrë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake ose deklarata në procedurë paraprake mund të përdoren në shqyrtim gjyqësor është e rregulluar me kujdes në Kodin e ri të Procedurës Penale.⁸⁴ Provat e siguruar gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor, por mund të përdoren gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmitarit nëse ai/ajo ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë

⁷⁸ Neni 237(4) thjesht përcakton se prokurori publik mund ta thërret të pandehurin, avokatin e tij/saj mbrojtës dhe palën e dëmtuar që të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit apo dëshmitarit ekspert. Neni 238 po ashtu i ka lejuar prokurorit ose të pandehurit që përjashtimisht mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të merr dëshmi nga dëshmitari me qëllim të ruajtjes së provës kur ekziston një mundësi e veçantë për marrjen e provës së rëndësishme ose kur ka rrezik të konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor (mundësia hetuese e veçantë).

⁷⁹ Sipas nenit 364 të KPPP, këto deklarata mund të përdoreshin nëse dëshmitarit nuk i janë kujtuar faktet të cilat i ka paraqitur më parë gjatë marrjes në pyetje, ose kur ai ose ajo i shmangej deklarimit të mëparshëm. Kryetari i trupit gjykues ose palët mund t'ia tërhiqin vërejtjen lidhur me deklarimin e mëparshëm dhe t'ia kërkonin shpjegim përse tani dëshmon ndryshe. Sipas nevojës, kryetari i trupit gjykues lexonte deklarimin e tij të mëparshëm ose pjesë të atij deklarimi. KPPP po ashtu nuk kishte saktësuar se në cilat rrethana të veçanta deklarata në procedurën paraprake mund të përdorej si dëshmi e drejtpërdrejtë. Janë zbatuar vetëm disa rregulla të përgjithshme, të cilat përshkruheshin në Pjesën II të KPPP për Provat.

⁸⁰ Neni 123 i KPP.

⁸¹ Shih nenin 149 të KPP (Mundësia Hetuese e Veçantë).

⁸² Neni 131 i KPP.

⁸³ Nenet 132 dhe 133 të KPP.

⁸⁴ Neni 261 i KPP (përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtim gjyqësor) dhe neni 337 (përdorimi i dëshmisë së mëparshme të dëshmitarit).

paraprake.⁸⁵ Në anën tjetër, dëshmia e marrë gjatë seancës për deklaratën në procedurë paraprake mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit.⁸⁶

Përgjithësisht, KPP përcakton në nenin 262 se gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur (i) vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale ; (ii) vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin ose (iii) vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Synimi i këtyre dispozitave të reja e të hollësishme është që të mbrojtë të drejtën e të pandehurit për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarëve në rast se prokurori dëshiron që të përdor deklaratat e dhëna në procedurë paraprake në shqyrtim gjyqësor. Në veçanti, neni 14(3)(e) i PNDCP dhe neni 6(3)(d) i KEDNJ garantojnë, në kontekst të procedurës penale, të drejtën “për të pyetur ose për të marrë në pyetje dëshmitarët të cilët dëshmojnë kundër tij”.⁸⁷ E drejta për marrjen e tërthortë në pyetje është një aspekt thelbësor i së drejtës për proces të rregullt. Ajo përcakton, në parim, që i akuzuari e gëzon mundësinë për të kundërshtuar çdo aspekt të deklaratës ose dëshmisë së dëshmitarit gjatë konfrontimit ose marrjes në pyetje.⁸⁸ Të gjitha provat zakonisht duhet të paraqiten në prani të të akuzuarit në seancë publike, duke pasur parasysh argumentet akuzatore.⁸⁹ Me fjalë të tjera, duhet të ketë arsyetim të mirë për mungesën e dëshmitarit.⁹⁰ Sidoqoftë, e drejta për proces të rregullt nuk e përfshin të drejtën absolute për sjelljen e një dëshmitari të caktuar për të dhënë dëshmi në gjykatë.⁹¹ Përdorimi si provë i deklaratave të dëshmitarit të marra gjatë fazës së procedurës paraprake nuk është në vetvete në kundërshtim me të drejtën për marrjen e tërthortë në pyetje, me kusht që të pandehurit ti jetë dhënë mundësia e duhur dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarin, kur ai dëshmitar e jep atë deklaratë ose në një fazë të mëvonshme të procedurës.⁹² Kur dënimi mbështetet vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratave të dhëna nga një person, të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësi ta pyes ose ta merr në pyetje, gjatë hetimit ose në shqyrtim gjyqësor, atëherë të drejtat e mbrojtjes janë të kufizuara deri në atë shkallë që janë në kundërshtim me garancitë e përcaktuara me nenin 6.⁹³ Përfundimisht, përkritazi me lejimin e gëzimit efektiv të së drejtës për marrjen e tërthortë në

⁸⁵ Neni 261(2) që i referohet nenit 123(2) të KPP.

⁸⁶ Neni 261(3) që i referohet nenit 123(3) të KPP. Shih po ashtu nenin 337(2) të KPP.

⁸⁷ *Bricmont kundër Belgjikës*, Aktgjykim i GJEDNJ, 7 korrik 1989, paragrafi 81.

⁸⁸ Po aty.

⁸⁹ *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i GJEDNJ, f. 34, par 78.

⁹⁰ *Vidgen kundër Holandës*, Aktgjykim i GJEDNJ, 10 korrik 2012, paragrafi 119.

⁹¹ *McLawrence kundër Xhamajkës*, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, komunikata nr. 702/1996 (26 prill 1996).

⁹² *Unterpertinger kundër Austrisë*, Aktgjykim i GJEDNJ, 24 nëntor 1986, paragrafët 14-15, § 31.

⁹³ Shih në veçanti GJEDNJ, rasti *Lucà kundër Italisë*, § 40, dhe GJEDNJ, rasti *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 119. Shprehja “vendimtare” u përshkrua në rastin *Vidgen*, paragrafi 40 dhe në rastin *Al-Khawaja*, paragrafi 131.

pyetje, Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka rikujtuar se ekziston e drejta për të zbuluar të gjitha shkresat e lëndës.⁹⁴

3.3.1.2. Deklaratat në procedurë paraprake dhe e drejta e të pandehurit për marrjen në pyetje të tërthortë të dëshmitarit

Në praktikë, prokurorët vazhdojnë të marrin “deklarata” nga dëshmitarët siç kanë bërë para hyrjes në fuqi të KPP të ri dhe nuk saktësojnë nëse deklaratat janë marrë gjatë seancës “të marrjes në pyetje” në procedurë paraprake ose gjatë seancës “së deklaratës” në procedurë paraprake.

Derisa 81 për qind e prokurorëve janë përgjigjur se ata “ndonjëherë” ose “shpesh” mbajnë seanca të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, dhe 75 për qind “ndonjëherë” ose “shpesh” mbajnë seanca të deklaratës në procedurë paraprake, deklaratat e dëshmitarëve që janë mbledhur në raste të shumta tregojnë se rezultatet e pyetësorit nuk e pasqyrojnë praktikën. OSBE-ja ka rishikuar 24 deklarata të dëshmitarëve që janë marrë nga prokurorët në të gjitha prokuroritë në Kosovë gjatë periudhës së raportimit. Këto dokumente tregojnë se prokurorët vazhdojnë të marrin “deklaratat” nga dëshmitarët siç kanë bërë para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale.⁹⁵ Dëshmia nga dëshmitarët nuk po merret gjatë “marrjes në pyetje në procedurë paraprake” ose “deklaratës në procedurë paraprake”, por thjesht gjatë seancave të marrjes në pyetje. Ato nuk i përmbajnë referencat ndaj ndonjë neni të KPP përkitazi me seancat e marrjes në pyetje në procedurë paraprake dhe deklaratës në procedurë paraprake.⁹⁶ Prandaj nuk është e mundur që të përcaktohet nëse dëshmia është marrë gjatë seancës së marrjes në pyetje në procedurë paraprake, ose gjatë seancës së deklaratës në procedurë paraprake. Gjithashtu në asnjë seancë të shqyrtimit gjyqësor që u monitorua nga OSBE-ja, ku palët përdorën deklaratat e dëshmitarëve të marra në procedurë paraprake, nuk u saktësua nëse këto deklarata ishin marrë gjatë seancës së deklaratës në procedurë paraprake ose gjatë seancës së marrjes në pyetje në procedurë paraprake. Përfundimisht, prokurorët e pranuan gjatë intervistave, të cilat u zhvilluan në vitin 2013, se ata nuk mbajnë seancë “të marrjes në pyetje në procedurë paraprake” ose seancë “të deklaratës në procedurë paraprake”.⁹⁷

Dokumentacioni i mbledhur tregon se prokurorët i marrin deklaratat nga dëshmitarët pa i respektuar formalitetet e përcaktuara në ligj. Prokurorët shpesh thërrasin avokatët mbrojtës, por jo edhe të pandehurin për të qenë i pranishëm në marrjen në pyetje të dëshmitarit. Edhe atëherë kur mbrojtja thërritet, kjo bëhet me anë të njoftimit në afat tepër të shkurtër. Gjithsej 70 për qind e avokatëve, të cilët janë përgjigjur në pyetësor, kanë deklaruar se ishin në përgjithësi të njoftuar nga prokurori për datën e seancës në më pak se dy ditë, ose mes dy dhe pesë ditëve më herët, e që paraqet shkelje të nenit 132(6) të KPP. Për më tepër, deklaratat nuk

⁹⁴ *Peart kundër Xhamajkës*, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, komunikatat 464/1991 dhe 484/1991, paragrafi 11.5.

⁹⁵ Deklaratave u referohet si “procesverbal i deklaratës së dëshmitarit”, “procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit”, “procesverbal i intervistës së dëshmitarit” ose “procesverbal i dëshmisë së dëshmitarit”. Deklaratat u mbledhën gjatë periudhës së raportimit dhe përfaqësojnë të shtatë rajonet e Kosovës.

⁹⁶ Ceken vetëm neni 125 për paralajmërimet të cilat duhet lexuar dëshmitarit para marrjes në pyetje dhe neni 129 për të drejtën e dëshmitarit për të mos e fajësuar veten ose të afërmit.

⁹⁷ Intervistat u zhvilluan nga data 14 qershor deri më datën 5 korrik 2013. U intervistuan 28 prokurorë në të gjitha rajonet e Kosovës. Ajo çka vlen të theksohet është se, sipas Komentarit për KPP (shih shënimin 41 më lart), dallimi mes “deklaratës në procedurë paraprake” dhe “marrjes në pyetje në procedurë paraprake” ka shkaktuar huti (f. 366).

incizohen me audio dhe video dhe 95 për qind e prokurorëve e kanë pranuar këtë fakt. Dokumentacioni i mbledhur po ashtu tregon se deklaratat e dëshmitarëve përgjithësisht nuk merren fjalë për fjalë; pyetjet shumicën e herës nuk transkriptohen dhe përgjigjet janë të riformuluara për të siguruar rrjedhë të mirë të fjalive.

Siç është diskutuar më lartë, dispozitat e reja të KPP-së janë dizajnuar për të siguruar respektim të drejtës së të pandehurit për marrje në pyetje të tërthortë të dëshmitarëve. Andaj, dështimi i prokurorëve për t'i zbatuar këto dispozita jo vetëm që mund të përbëjë shkelje të procedurës penale por edhe të drejtave të të pandehurit për gjykim të drejtë. Për shembull, OSBE-ja i ka monitoruar shtatë raste gjatë se cilave deklaratat e disa dëshmitarëve në procedurën paraprake – për të cilat nuk është specifikuar nëse janë marr gjatë seancave të marrjes në pyetje në procedurë paraprake apo deklaratës në procedurë paraprake – janë përdorur si dëshmi të drejtpërdrejta gjatë gjykimit sepse dëshmitarët nuk ishin paraqitur.⁹⁸ Mirëpo, mbrojtja nuk ka qenë e pranishme gjatë marrjes së këtyre deklaratave në procedurën paraprake. Duke qenë se mbrojtja në këto raste nuk ka pasur mundësi për t'i sfiduar dhe marrë në pyetje dëshmitarët në asnjërën fazë të procedurës, mund të thuhet që e drejta e të pandehurve për marrje në pyetje të tërthortë nuk është respektuar. Gjykata në këto raste ka vendosur që t'i shfrytëzoj deklaratat e dëshmitarëve nga procedura paraprake sepse ishin pajtuar edhe mbrojtja edhe prokurori, por nuk e kishte verifikuar nëse mbrojtja ka pasur mundësi që t'i merr në pyetje dëshmitarët që i kanë dhënë këto deklarata në ndonjërin fazë të procedurës.

Deklaratat e dëshmitarëve në procedurën paraprake mund të jenë të rëndësishme për t'u përdorur gjatë gjykimit, veçanërisht nëse deklarata është dhënë nga dëshmitari kyç. Andaj, ato duhet të merren sipas procedurës së duhur, përndryshe mund të refuzohen gjatë gjykimit dhe kjo mund të rezultojë në rrënim të rastit të prokurorit. Kjo ka qenë brengë e vazhdueshme dhe është ngritur nga OSBE-ja qysh në vitin 2003.⁹⁹

Në frymë të vështirësive me të cilat ballafaqohen prokurorët në zbatimin e këtyre dispozitave, Kryeprokurori mund t'i shqyrtojë arsyet përse këto dispozita janë problematike dhe mund të lëshoj udhëzime për t'i ndihmuar prokurorëve në zbatimin e tyre.

3.3.2. Mbështetja e pohimit

Udhëzuesi për KPP e sqaron që prokurori duhet të mendoj për provat dhe, nëse është e nevojshme, të gjejë mbështetje për provat që nuk janë aq të besueshme, relevante apo të bindshme sa dëshiron ai/ajo.¹⁰⁰ Kur të nevojitet mbështetja, do të dorëzohet mbështetja e pohimit. Kjo është mjet i ri që ofrohet në KPP. Sipas Udhëzuesit të KPP-së, ky mjet është shtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila e kufizon përdorimin e

⁹⁸ Deklaratat në procedurën paraprake të dëshmitarëve janë “lexuar” gjatë gjykimit sepse dëshmitarët nuk janë paraqitur. Në fakt, është e qartë që deklaratat vetëm janë “lexuar”, por nuk janë përdorur si prova të drejtpërdrejta.

⁹⁹ Raporti i OSBE-së, *Rishikimi i Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë* (Maj 2003), <http://www.osce.org/kosovo/12555>, fq. 41-42. OSBE-ja ka theksuar që në disa raste të trafikimit, në fazën e gjykimit gjyqtarët kanë pranuar prova nga procedurat në rrethana ku të akuzuarit apo mbrojtësit të tij/saj nuk iu është dhënë mundësia e sfidimit të tyre. Në rastet e trafikimit dëshmitarët kryesor janë zakonisht viktimat e trafikimit dhe derisa atom und të japin dëshmi në fazën e hetimeve të procedurës penale, në shumicën dërmuese të rasteve ato nuk marrin pjesë në gjykim, ngase zakonisht riatdhesohen para se të filloj gjykimi.

¹⁰⁰ Udhëzuesi për KPP, f. 29.

provave kur i pandehuri ka qenë i kufizuar në konfrontimin e dëshmitarit.¹⁰¹ Neni 19(1.31) i KPP-së e përkufizon mbështetjen e pohimit si në vijim: “dokument i paraqitur nga pala në mbështetje të dëshmisë apo provës që nuk është drejtpërdrejtë e arritshme në shqyrtim gjyqësor. Mbështetja e pohimit cakton prova tjera të pranishme që mbështesin dëshminë apo provën në fjalë. Mbështetja e pohimit ka për qëllim të tregojë se prova në fjalë nuk do të ishte prova e vetme apo vendimtare në mbështetje të aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet fajtor”.¹⁰²

Në praktikë, nuk është duke u shfrytëzuar ky dokument i ri. Gjithsej 64 për qind e prokurorëve të cilët janë përgjigjur në pyetësor kanë thënë se kanë parashtruar “ndonjëherë” apo “shpesh” mbështetje të pohimit. Mirëpo, 16 prokurorë, përfshirë kryeprokurorë, janë intervistuar gjatë periudhës raportuese në lidhje me këtë çështje. Ata në përgjithësi e kanë pranuar që nuk parashtrorin mbështetje të pohimit. Sipas tyre, këto dokumente nuk janë të dobishme gjatë procedurave. Përveç kësaj, 68 për qind e gjyqtarëve dhe 40 për qind e avokatëve të anketuar përmes pyetësorit kanë thënë që prokurorët “rrallëherë apo asnjëherë” nuk parashtrorin mbështetje të pohimit së bashku me aktakuzën. Për më tepër, asnjëra nga aktakuzat e parashtruara pas janarit 2013 dhe të mbledhura nga OSBE-ja gjatë periudhës raportuese nuk i referohen ndonjë mbështetjeje të pohimit. Gjithashtu ato nuk përmenden as gjatë gjyqimeve.

3.3.3. Negocimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë

3.3.3.1. Administrimi efektiv i drejtësisë

Sipas KPP-së i pandehuri mund ta pranojë fajësinë gjatë procedurës së rregullt (në seancën fillestare, seancën e dytë apo shqyrtimin gjyqësor). Mirëpo, KPP gjithashtu përmban procedura që i lejojnë palët të negociojnë marrëveshjet e shkruara mbi pranimin e fajësisë për administrim më efikas të drejtësisë.¹⁰³ Deri në një masë të caktuar, procedura të tilla kanë ekzistuar edhe në Kodin e mëparshëm të Procedurës.¹⁰⁴ Mirëpo, sipas KPP-së të ri, prokurori tani mund të iniciojë marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë jo vetëm pas ngritjes së aktakuzës por edhe para këtij momenti. Një tipar tjetër i kodit të ri është mundësia që prokurori të rekomandojë dënim më të butë, deri në masën e lejuar me këtë kod, varësisht nga koha kur është arritur marrëveshja: gjatë shqyrtimit kryesor, para shqyrtimit kryesor, dhe varësisht se a

¹⁰¹ Udhëzuesi për KPP, f. 37.

¹⁰² Neni 263(1) i KPP-së e specifikon që prokurori i cili synon që të mbështetet në deklaratat e mëparshme në bazë të nenin 261, duhet të paraqesë mbështetje të pohimit. Ajo duhet të paraqitet së bashku me aktakuzën, por jo më vonë se në fillimin e shqyrtimit kryesor (neni 263(3) KPP). Në fund, neni 243 (1.1) i KPP-së thotë që prokurori i shtetit paraqet mbështetjen e pohimit së bashku me deklaratat e marra nga neni 132, pra deklaratën e regjistruar gjatë seancës së procedurës paraprake nëse ai apo ajo synon të paraqesë si prova të drejtpërdrejta pa praninë e dëshmitarëve.

¹⁰³ Në lidhje me marrëveshjet gjatë procedurës së rregullt: Neni 246(4) i KPP-së kërkon që gjyqtari në fillim të shqyrtimit fillestar “të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm” (shih edhe nenin 248 të KPP-së: pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar). Gjyqtari ia jep këtë mundësi të pandehurit edhe në fillim të shqyrtimit kryesor (neni 325). Me KPPP, i pandehuri ka mundur ta pranojë fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm edhe në fillim të seancës për konfirmimin e aktakuzës (neni 314 dhe 315 i KPPP-së) dhe në fillim të shqyrtimit kryesor (nenet 358 dhe 359 të KPPP-së).

¹⁰⁴ Një nënkaptull për “Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë” iu është shtuar kodit të mëparshëm të procedurës penale në nëntor të vitit 2008. Ligji nr. 03/L003 për ndryshimin e plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës nr. 2003/26. Sipas nenit 308A i pandehuri dhe prokurori mund t’i negociojnë kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me shkrim në të cilën i pandehuri është pajtuar për ta pranuar fajësinë.

merr pjesë i pandehuri në cilësi të dëshmitarit bashkëpunues.¹⁰⁵ Sipas udhëzuesit, kjo paraqet një ndryshim tjetër në rolin e prokurorit. Marrëveshja e negociuar mbi pranimin e fajësisë është alternativa më e rëndësishme ndaj gjykimit.¹⁰⁶

Si reflektim i rëndësisë së këtij elementi të KPP-së, Kryeprokurori i shtetit (së bashku me Kryeprokurorin e EULEX-it) në nëntor të vitit 2013 i kanë nxjerr udhëzimet në lidhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Këto udhëzime janë nxjerr me qëllim të kanalizimit të aktiviteteve të prokurorit në lidhje me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Udhëzimet tregojnë se çka duhet të përmbaj marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë dhe çka prokurori mund (dhe nuk mund) të ofrojë si pjesë e procesit të negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Udhëzimet i trajtojnë edhe përgjegjësitë e prokurorëve drejt palëve të dëmtuara si pjesë e procesit të negocimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe detyrat e tyre në lidhje me çështjen e konfiskimit të objekteve dhe përfitimit material të krimit.¹⁰⁷ Mosrespektimi i udhëzimeve konsiderohet si shkelje e rëndë e Kodit të Etikës për Prokurorë.

3.3.3.2. Pranimi i fajësisë gjatë procedurave të rregullta

Në praktikë, palët ende rrallëherë e negociojnë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Gjithsej 61 përqind e gjyqtarëve që janë përgjigjur në pyetësor kanë theksuar që ata “rrallëherë apo asnjëherë” nuk kanë parashtruar marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Përkundër kësaj 45 përqind e avokatëve dhe 51 përqind e prokurorëve kanë thënë që “rrallëherë apo asnjëherë” nuk i negociojnë marrëveshjet e tilla. Sipas statistikave të pranuar nga KGJK, marrëveshjet e negociuara mbi pranimin e fajësisë janë përdorur në vetëm 3 përqind të rasteve që janë trajtuar nga prokuroritë në tërë Kosovën ndërmjet prillit dhe qershorit 2015.

Monitorimi i OSBE-së ka treguar që një numër domethënës i të pandehurve pajtohet që ta pranojnë fajësinë por nuk e bënë këtë përmes marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Në vend të kësaj, të pandehurit e pranojnë fajësinë gjatë procedurës së rregullt. Për shembull, 408 shqyrtime fillestare produktive janë monitoruar në departamentin e përgjithshëm dhe atë të krimeve të rënda. Në 101 nga to të pandehurit e kishin pranuar fajësinë (25 përqind e seancave). Në krahasim me këtë, vetëm në tetë raste të monitoruara gjatë periudhës raportuese, pranë dy departamenteve, ishin marrëveshje të shkruara mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet palëve.¹⁰⁸ Në dy raste tjera, palët kanë bërë përpjekje për të arritur marrëveshje por pa ndonjë rezultat. Statistikat e mara nga KGJK gjithashtu tregojnë që numri i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet palëve është i ulët: vetëm 171 marrëveshje janë arritur ndërmjet prillit dhe qershorit 2015 nga 5925 raste të proceduara nga shtatë prokuroritë.¹⁰⁹

¹⁰⁵ Neni 233(7) i KPP-së parasheh që prokurori i shtetit mund të rekomandojë dënim më të butë se minimum i mundshëm i burgimit i vendosur me Kodin Penal. Varësisht nga faza e procedurës, propozimi mund të shkojë nga 90% të minimumit (nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë arrihet në shqyrtimin kryesor), 80 përqind, 60 përqind apo edhe deri 40 përqind për të pandehurit të cilit i jepet statusi i “dëshmitarit bashkëpunues”.

¹⁰⁶ Udhëzuesi për KPP-në, f 30 dhe 62. Shih edhe komentaret për KPP-në, (*shënimi 41 më lart*) f 571-605.

¹⁰⁷ Udhëzimet për Marrëveshjet mbi Pranimin e Fajësisë, Zyra e Kryeprokurorit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it, 13 nëntor 2013, adresuar të gjithë prokurorëve në Kosovë, http://www.psh-ks.net/repository/docs/Instructions_on_guilty_plea_agreements.pdf.

¹⁰⁸ Duhet të theksohet që gjykatat nuk mbajnë asnjë statistikë zyrtare për numrin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë të arritura ndërmjet prokurorëve dhe të pandehurve.

¹⁰⁹ Implementimi i Procedurave Alternative, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, f.7.

Nga 11 prokurorë që janë intervistuar gjatë periudhës raportuese, pesë nga ta e kanë shprehur ngurrimin e tyre në përdorimin e kësaj alternative pasi që është proces i ngarkuar. Prokurori për shembull, kërkohet që ta njoftoj kryeprokurorin e prokurorisë së tij/saj, i cili/e cila duhet të jep autorizim me shkrim për takimin preliminar me qëllim të fillimit të negociatave për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Prokurorët me sa duket e kanë anashkaluar faktin që mund të përfitojnë nga incizimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 233 të KPP-së. Në fakt bashkëpunimi me të pandehurin mund t'i avancoj hetimet.¹¹⁰

Një arsye tjetër përse ka numër të vogël të marrëveshjeve mbi pranimin të fajësisë me sa duket është që të pandehurit që e pranojnë fajësinë gjatë procedurave të rregullta edhe ashtu pranojnë dënime të ulëta, apo edhe nën minimumin e paraparë me ligj.¹¹¹ Andaj, të pandehurit mund të mos kenë motivim për të negociuar marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë me shkrim. Raporti i konsoliduar i KGJK-së e ka përmendur që, kur të pandehurit e pranojnë fajësinë gjatë gjykimit, gjykatat “mjaftë shpesh” u shqiptojnë dënim nën minimumin e paraparë ligjor, duke u arsyetuar që ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese në rast. Ai më tutje rekomandon që gjykatat duhet t'i rishikojnë politikat tyre me qëllim të rritjes së numrit të rasteve në të cilat do të arrihet marrëveshje e negociuar mbi pranimin e fajësisë.¹¹²

Gjithashtu, në rastet e monitoruara gjatë së cilave palët kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë apo kanë shprehur vullnet për të, aktakuza tashmë ishte ngritur. Kjo tregon që nuk është duke u zbatuar as dispozita e re e KPP-së e cila u lejon palëve që ta negociojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës. Raporti i konsoliduar i KGJK-së thekson që “shumica e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë janë arritur pas ngritjes së aktakuzave”.

Një çështje tjetër që është vërejtur është që gjykatat shpesh dështojnë që të vendosin afate për negociatat. Vetëm tetë për qind e avokatëve të anketuar kanë thënë që gjykata “shpeshherë” vendos afate për negociimet; 16 për qind e prokurorëve të anketuar kanë dhënë të njëjtën përgjigje; dhe vetëm gjashtë për qind e gjyqtarëve e kanë pranuar këtë fakt. Neni 233(10) i KPP-së ua ndalon gjyqtarëve pjesëmarrjen në negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë por ua lejon atyre që të “caktojnë afat të arsyeshëm kohor, jo më të gjatë se tre (3) muaj, për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohet zvarritja e procedurës”. Në tri raste të monitoruara nga OSBE-ja, gjykata nuk e ka vendosur afatin, por e ka caktuar datën për fillimin e shqyrtimit gjyqësor duke pritur nga palët që të arrijnë marrëveshje në ndërkohë. Një vendim i tillë nuk duket të jetë vendimi i duhur sepse nëse palët nuk arrijnë marrëveshje gjatë asaj periudhe kohore, gjykimi do të filloj pa ia dhënë të pandehurit mundësinë e shfrytëzimit të drejtës së tij/saj të parashtrimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës apo për t'i kundërshtuar provat para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.¹¹³ Gjithashtu ndodh që gjykata ta

¹¹⁰ Udhëzuesi për KPP-në, f. 23.

¹¹¹ Pranimi i fajësisë është me të vërtetë faktor që duhet marrë në konsideratë nga gjykata kur të vendos për dënimin (neni 73(3.6) KP). Shih edhe raportin e OSBE-së *Vlerësimi i joadekuatit të rrethanave lehtësuese dhe rëndues nga gjykata* (korrik 2010), <http://www.osce.org/kosovo/70907>.

¹¹² Raporti i konsoliduar i KGJK-së (shënimi 9 më lart), f.3.

¹¹³ Neni 246 thotë që gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë në pafajshëm. Nëse i pandehuri vendos që të mos e pranojë fajësinë, ai/ajo duhet ta ketë të drejtën që të parashtrij kundërshtim ndaj provave dhe të kërkojë hudhjen e aktakuzës. Sipas nenit 254(5) të KPP-së, gjyqtari cakton shqyrtimin gjyqësor nëse kundërshtimet apo kërkesat e tilla janë duke u shqyrtuar. Shih edhe nenin 255(5) i KPP-së thekson që, gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marrë aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.

shtyjë rastin për kohë të pacaktuar pasi që pala ta ketë shprehur vullnetin për ta negociuar marrëveshjen me prokurorin.

3.3.4. Alternativat tjera ndaj gjykimit

Para ngritjes së aktakuzës, kur është e përshtatshme dhe në interes publik, prokurorët duhet ta marrin para sysh përdorimin e alternativave ndaj gjykimit të parapara në nenin 229 të KPP-së.¹¹⁴ Janë katër lloje të alternativave. Lloji i parë, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, është alternativa më e rëndësishme, siç është shpjeguar më lart (3.3.3). Prokurorët e kanë mundësinë edhe të pezullimit të përkohshëm të procedurës (neni 230 i KPP-së), heqjes dorë nga ndjekja kur ajo nuk është e detyrueshme (neni 231 i KPP-së), apo referimit të rastit në ndërmjetësim (neni 232 i KPP-së).

Në praktikë, këto alternativa ndaj gjykimit rrallëherë shfrytëzohen nga prokurorët. Vetëm tre për qind e prokurorëve të anketuar kanë thënë që “shpesh” e kanë pezulluar ndjekjen e veprave penale në bazë të nenit 230 të KPP-së dhe 70 për qind e tyre janë përgjigjur që e bëjnë këtë “rrallëherë apo asnjëherë”. Ngjashëm me këtë, vetëm shtatë për qind e tyre kanë thënë që “shpesh” i referojnë rastet për ndërmjetësim dhe 76 për qind janë përgjigjur që e bëjnë këtë “rrallëherë apo asnjëherë”. Gjithsej 85 për qind e avokatëve të anketuar kanë thënë që ata kanë marr pjesë “rrallëherë ose asnjëherë” në raste ku prokurori e ka pezulluar ndjekjen e një veprave penale në bazë të nenit 230, dhe 86 për qind janë përgjigjur që kanë qenë të përfshirë “rrallëherë apo asnjëherë” në rastet e dërguara nga prokurori për ndërmjetësim. Sipas statistikave të marra nga KGJK, alternativat ndaj gjykimit (me përjashtim të marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë) janë përdorur në vetëm gjashtë për qind të rasteve të cilat i kanë trajtuar prokuroritë në tërë Kosovën ndërmjet prillit dhe qershorit 2015.

Në këtë aspekt, OSBE-ja dëshiron t'i theksoj përpjekjet shumë të lavdërueshme të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për rritjen e përdorimit të procedurave alternative në tërë Kosovën, përmes një serie të trajnimeve në shtator të vitit 2015, të mbështetura nga OSBE-ja, për të gjitha prokuroritë në tërë Kosovën për përdorimin e këtyre procedurave alternative ku është avokuar në masë të madhe për përdorim më të madh të këtyre procedurave nga të gjithë prokurorët.

3.4. Roli i ri i palës së dëmtuar

Sipas KPP-së, pala e dëmtuar ka rol më të madh në procedurë, si në fazën e mbledhjes së provave (faza e hetimit) ashtu edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Pjesa e mëposhtme e shqyrtton nëse palët e dëmtuara kanë parashtruar deklaratë për dëmin, nëse tani përfaqësohen më shpesh nga mbrojtësit e viktimave, dhe cili është roli i tyre gjatë shqyrtimit fillestar dhe të dytë.

¹¹⁴ Udhëzues i për KPP-në, f. 61.

3.4.1. Deklarimi i dëmeve

Deklarimet e dëmeve nuk kanë ekzistuar në kodin e mëparshëm të procedurës. Mirëpo, pala e dëmtuar kishte të drejtë që të parashtrijë kërkesë pasurore në procedurë penale.¹¹⁵ KPP i ri e përmban edhe një kapitull për kërkesat pasurore me dispozita që janë identike me ato që gjendeshin në kodin e mëparshëm të procedurës.¹¹⁶

KPP- i ri e përmban një nen të ri për “Deklarimin e dëmit nga pala e dëmtuar”. Sipas nenit 218 të KPP-së gjatë fazës hetimore apo brenda 60 ditëve prej ngritjes së aktakuzës, i dëmtuari mund të paraqesë një deklaratë të thjeshtë të dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Mbrojtësi i viktimave mund të ndihmojë të dëmtuarin në paraqitjen e deklaratës së dëmit. Deklarimi i dëmit duhet të përmbajë: (i) emrin e personit i cili ka shkaktuar dëmin; (ii) mënyrën se si ka ardhur deri te dëmi; (iii) si është shkaktuar dëmi nga vepra penale apo si ka qenë dëmi rezultat i parashikuar i veprës penale; dhe (iv) nëse ka pasur shpenzime të shkaktuara si rezultat i dëmit apo humbjeve të shkaktuara nga vepra penale, në deklaratë caktohet vlerësimi i arsyeshëm i shpenzimeve apo humbjeve.¹¹⁷ Nëse deklarimi i dëmeve parasheh vlerësimin e shpenzimeve apo humbjeve, ajo shërben si kërkesë pasurore.¹¹⁸

Formulari për deklarin e dëmeve ka qenë në dispozicion nga viti 2013.¹¹⁹ Në formular pala e dëmtuar ka mundësi që ta përshkruajë ndikimin fizik, financiar dhe emocional të veprës penale, që përfshinë lëndimet fizike, shumë e shpenzimeve mjekësore apo dëmtimit të pronës si rezultat i veprës penale (p.sh. sendet e dëmtuara apo vjedhura dhe fitimi i humbur), si dhe ndikimin psikologjik që vepra e ka pasur tek pala e dëmtuar apo anëtar i familjes së saj. Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, që kanë hyrë në fuqi në tetor të vitit 2013, theksojnë që mbrojtësit e viktimave mund t’iu ndihmojnë viktimave në përgatitjen dhe dorëzimin e deklarimeve të tilla.¹²⁰

Mirëpo, në praktikë, deklarin e dëmit parashtrihen rrallë. Gjithsej, 58 për qind e prokurorëve dhe 74 për qind e gjyqtarëve të anketuar janë përgjigjur që janë “rrallëherë apo asnjëherë” të përfshirë në rast në të cilin deklarata e dëmeve është dorëzuar gjatë fazës së hetimeve apo menjëherë pas ngritjes së aktakuzës. Derisa, 77 për qind e avokatëve kanë thënë që ata “nganjëherë” apo “shpesh” i kanë ndihmuar palës së dëmtuar në parashtrimin e deklaratës së dëmit.¹²¹ Mirëpo, asnjë deklaratë e dëmit nuk është diskutuar apo përmendur

¹¹⁵ Neni 80 i KPPPK. Kapitulli XII i KPPPK e rregullonte mënyrën se si kërkesat pasurore duhet të parashtrihen dhe vendosen.

¹¹⁶ Kapitulli XXV i KPP.

¹¹⁷ Neni 218(3) i KPP.

¹¹⁸ Neni 218(6) i KPP.

¹¹⁹ OSBE-ja i ka intervistuar gjashtë mbrojtës të viktimave nga gjashtë nga gjithsej shtatë rajone në Kosovë, ndërmjet muajit qershor dhe korrik 2014. Sipas këtyre intervistave, disa kanë filluar që ti përdorin këta formularë qysh në janar të vitit 2013 (Peja/Peć), derisa tjerët më vonë, kah fundi i vitit 2013 dhe fillimi i vitit 2014.

¹²⁰ Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (October 2010), neni 30, http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/No.1202.2013_Directive_on_SOP_FOR_THE_VPAO.pdf.

¹²¹ Nga 81 avokatë, 35 janë përgjigjur që “nganjëherë” e kanë përfaqësuar palën e dëmtuar në procedurë penale, dhe 14 tjerë janë përgjigjur që e kanë bërë këtë “shpesh”. Nga këta 49 avokatë, 11 “rrallëherë ose asnjëherë” e kanë ndihmuar palën e dëmtuar në plotësimin e deklarin të dëmit, 25 e kanë bërë këtë “nganjëherë” dhe 13 “shpesh”. Nga 38 avokatë që kanë thënë se “nganjëherë” apo “shpesh” e kanë ndihmuar palën e dëmtuar në dorëzimin e deklarin për dëmin, katër janë përgjigjur që deklarimi “shpesh” përdoret nga gjykata për të vendosur për kërkesën pasurore; 19 janë përgjigjur “nganjëherë” dhe 15 janë përgjigjur “rrallëherë apo asnjëherë”.

nga palët dhe/apo gjykatat gjatë seancave të monitoruara, e as nuk iu janë referuar atyre në aktgjykimet e shkruara të mbledhura nga OSBE-ja. Për më tepër, gjashtë mbrojtës të viktimave të anketuar që i kanë përfaqësuar gjashtë nga shtatë zyrat për mbrojtje dhe ndihmë viktimave në Kosovë, kanë sqaruar që ndonëse palët e dëmtuara fuqimisht inkurajohen që ta bëjnë deklarin e dëmeve, ato shpesh nuk e bëjnë një gjë të tillë, edhe kur e kanë bërë atë, siç e kanë sqaruar mbrojtësit e viktimave, deri më tani kjo nuk është treguar e frytshme, qoftë për shkak se gjykimet ende nuk ishin përfunduar apo për shkak se gjykatat nuk i kanë shfrytëzuar deklarinimet për të vendosur për kërkesat pasurore. Kjo është konfirmuar nga përgjigjet e siguruara nga prokurorët dhe gjyqtarët e anketuar. Gjithsej, 65 për qind e prokurorëve kanë thënë që, në rastet ku janë dorëzuar deklarinimet, gjykata “rrallëherë ose asnjëherë” nuk i ka përdorur ato për të vendosur për kërkesën pasurore derisa 67 për qind e gjyqtarëve kanë thënë që “rrallëherë ose asnjëherë” nuk e përdorin deklarinimet për të vendosur për kërkesën pasurore.

3.4.2. Mbrojtësi i viktimës gjatë gjykimet

Në kodin e mëparshëm të procedurës, pala e dëmtuar kishte të drejta të caktuara gjatë gjykimet, pra: për të propozuar prova, për t’i bërë pyetje të pandehurit, dëshmitareve dhe dëshmitarëve ekspertë, për të bërë vërejtje dhe paraqitur sqarime në lidhje me dëshminë dhe për të dhënë deklarata tjera e parashtruar kërkesa.¹²² Mirëpo, pala e dëmtuar nuk është konsideruar të jetë “palë” në procedurë *per se*. Pala e dëmtuar kishte mundësi që t’i ushtroj të drejtat e tij saj përmes përfaqësuesit të autorizuar, që mund të ishte mbrojtësi i viktimës.¹²³ Në raste të caktuara të dhunës në familje dhe krimeve të dhunës seksuale, pala e dëmtuar është dashur të ketë përfaqësues të tillë nga fillimi i procedurës penale. Mbrojtësit e viktimave gjithashtu e kishin si obligim të përgjithshëm për t’i asistuar palët e dëmtuara dhe për t’i mbrojtur të drejtat e tyre.¹²⁴

Në kodin e ri, pala e dëmtuar ka “statusin e palës” në procedurë penale.¹²⁵ Kjo do të thotë, për shembull, se gjatë gjykimet, pala e dëmtuar mund të paraqesë prova dhe mund të marrë në pyetje dëshmitarët¹²⁶. Pala e dëmtuar mund të përfaqësohet nga një avokat, nga një mbrojtës i viktimës ose mund ta përfaqësojë veten¹²⁷. Sipas PSV-ve të tetorit 2013, mbrojtësit e viktimave duhet të përfaqësojnë viktimat në pesë lloje të veprave penale specifike: veprat penale të trafikimit, veprat penale të dhunës në familje dhe veprat penale kundër integritetit seksual, vrasjet dhe grabitjet. Fakti që mbrojtësit e viktimave tani mund t’i përfaqësojnë viktimat në raste të vrasjes dhe grabitjes është risi.

Megjithatë, në praktikë, pala e dëmtuar ende rrallëherë përfaqësohet nga mbrojtësi i viktimës. Në 82 raste të vrasjeve të monitoruara gjatë periudhës së raportimit, vetëm në një rast pala e dëmtuar ishte përfaqësuar nga mbrojtësi i viktimës. Pala e dëmtuar në të njëjtën kohë përfaqësohej nga një avokat. Gjithashtu, janë monitoruar 26 gjykime të grabitjes para departamentit të krimeve të rënda. Në asnjë nga këto raste pala e dëmtuar nuk u përfaqësua nga mbrojtësi i viktimës.

¹²² Neni 80 KPPP.

¹²³ Neni 81(1) KPPP.

¹²⁴ Neni 81(4) i KPPP.

¹²⁵ Neni 62(1.3) i KPP.

¹²⁶ Nenet 327(1.3) dhe 332(2) të KPP.

¹²⁷ Neni 63 i KPP.

3.4.3. Prania e palës së dëmtuar gjatë shqyrtimit fillestar dhe të dytë

Me kodin e mëparshëm nuk kishte shqyrtime fillestare, por vetëm seancë të konfirmimit të aktakuzës, për të cilën pala e dëmtuar është dashur të “ftohet”.¹²⁸ Dispozitat që kanë të bëjnë me fazën e aktakuzës në Kodin e ri janë të paqarta, për atë nëse pala e dëmtuar do të ftohet të merr pjesë në shqyrtim fillestar. Neni 245 i KPP-së përcakton që “Gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit”. Pala e dëmtuar nuk është e cekur. Megjithatë, neni 248(2) i KPP-së përcakton që, vlerësimin e pranimit të fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Megjithatë, është e paqartë nëse nga kjo dispozitë duhet të kuptohet që pala e dëmtuar në përgjithësi duhet të ftohet të merr pjesë në të gjitha shqyrtimet fillestare, ose që pala e dëmtuar duhet të ftohet vetëm kur i pandehuri pranon fajësinë gjatë atij shqyrtimi. Kjo çështje është ngritur edhe në Raportin e Konsoliduar të KGJK-së i cili thekson se “Ka mospërputhje në Kod në lidhje me pjesëmarrjen e të dëmtuarit në shqyrtimin fillestar”.

Sipas kodit të mëparshëm, në fund të shqyrtimit të konfirmimit, nëse gjyqtari vendoste për hedhje të aktakuzës, pala e dëmtuar kishte mundësinë që të ushtrojë ankesë në atë vendim.¹²⁹ Nëse ankesa është e suksesshme, pala e dëmtuar është konsideruar se e ka ndërmarr ndjekjen si paditës subsidiar. Mundësia e ndjekjes subsidiare është hequr me KPP-në e re. Udhëzuesi për KPPN-në shpjegon se “për të balancuar humbjen e së drejtës së ndjekjes private, të drejtat e viktimave janë rritur ndjeshëm në këtë Kod të ri të Procedurës Penale”. Sipas nenit 62, pala e dëmtuar ka një serë të drejtash [duke përfshirë të drejtën] për të qenë palë në procedurë¹³⁰. Prandaj, Gjykata Supreme mund të dëshirojë që, përmes një seance të përgjithshme¹³¹, të sqarojë nëse pala e dëmtuar duhet të ftohet të merr pjesë në shqyrtim fillestar.

Në praktikë, pala e dëmtuar rrallëherë është e pranishme në shqyrtime fillestare. Janë monitoruar gjithsej 408 shqyrtime fillestare produktive pranë departamenteve për krime të përgjithshme dhe të rënda gjatë periudhës së raportimit. Të dëmtuarit ishin të pranishëm në vetëm 14 seanca të mbajtura para Departamentit të Krimeve të Rënda dhe atij të Përgjithshëm¹³². Në përgjithësi, 27 për qind e gjyqtarëve që janë përgjigjur në pyetësor kanë theksuar se i kanë ftuar palët e dëmtuara “rrallëherë ose asnjëherë” për të marrë pjesë në shqyrtim fillestar, ndërsa, 29 për qind e tyre theksuan e bëjnë këtë “herë pas here”, dhe 44 për qind e bëjnë këtë “shpesh”. Kjo tregon një praktikë jokonsistente në gjykata për sa i përket çështjes nëse pala e dëmtuar duhet të ftohet të merr pjesë në shqyrtim fillestar.

¹²⁸ Neni 309(2) i KPPP. Neni 313(2) i KPPP gjithashtu shprehimisht thekson se “pala e dëmtuar ka të drejtë të merr pjesë”. Gjatë seancës, gjyqtari i lejon palës së dëmtuar që të bëjë një deklaratë (neni 314(5) i KPP). Përveç kësaj, neni 311 përcakton që, në rast se i pandehuri vendos të heq dorë nga seanca e konfirmimit të aktakuzës dhe dorëzon kundërshtim me shkrim ndaj aktakuzës apo pranueshmërisë së dëshmitëve, kundërshtimi është dashur të shërbehet menjëherë për prokurorin dhe palën e dëmtuar (neni 311(2) i KPPP). Prokurori dhe pala e dëmtuar pastaj mund të parashtrajnë deklaratat e tyre me shkrim brenda tetë ditëve pas pranimit të kundërshtimeve (neni 311(3) i KPPP).

¹²⁹ Neni 317(3) i KPPP.

¹³⁰ Udhëzuesi për KPP, f. 22. Sipas komentareve për KPP, prania e palës së dëmtuar në shqyrtim fillestar nuk është ndaluar me asnjë dispozitë. Përveç kësaj, pala e dëmtuar është palë në procedurë (f. 635).

¹³¹ Ligji për Gjykatat, neni 23.

¹³² Megjithatë, duhet të theksohet se në disa raste nuk ka palë të dëmtuar (për shembull në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve apo në rastet e narkotikëve). Për më tepër, në shumë seanca ku pala e dëmtuar nuk ishte e pranishme nuk ishte e qartë nëse ajo nuk ishte e pranishme sepse nuk ishte ftuar nga gjykata, apo thjeshtë sepse nuk ka mundur të vij.

Për më tepër, është shqetësuese që në 28 rastet e monitoruara, gjyqtari ka vazhduar me shqiptimin e dënimit në shqyrtim fillestar pasi i pandehuri pranoi fajësinë edhe pse pala e dëmtuar nuk ishte e pranishme. Gjyqtarët nuk e ngritën çështjen nëse do të ishte e nevojshme që të shtyhet seanca për t'i dhënë palës së dëmtuar mundësinë për t'i paraqitur pikëpamjet e saj dhe/ose për t'i paraqitur kërkesat pasurore në një seancë tjetër¹³³. Neni 248(2) i KPP-së nuk obligon gjykatën që të kërkojë pikëpamjet e palës së dëmtuar kur shqyrton pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar¹³⁴. Megjithatë, do të ishte gjëja e duhur që prokurori ose gjyqtari të paktën ta ngritin çështjen nëse pala e dëmtuar do të duhej apo jo të ftohej në seancë për të paraqitur pikëpamjet e saj.

3.5.Roli i ri i gjyqtarit

Me KPP-në e ri, roli i gjyqtarit ka kaluar nga një rol shumë proaktiv në një rol më pak proaktiv në procedurë, gjersa mbrojtja dhe prokuroria kanë marrë më shumë përgjegjësi. Megjithatë, gjykatësi mbetet “mbrojtës i të drejtave” dhe ka detyrime të qarta të reja me KPP për të mbrojtur të drejtat e palëve. Pjesët në vijim shqyrtojnë nëse gjyqtarët i përmbushin disa nga përgjegjësitë e tyre të reja, si: vendosja në ankesat për paraburgim brenda 48 orëve; përfundimi i gjykimeve brenda kufijve të rinj kohorë; nxjerrja e aktgjykimeve të shkruara në kohë të duhur, si dhe vendime të arsyetuara për sfidat e aktakuzës nga ana e mbrojtjes; dhe sigurimi i audio/video incizimit të shqyrtimit gjyqësor.

3.5.1. Afatet kohore që kanë të bëjnë me paraburgimin

Neni 164(7) i KPP parasheh që “Brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit”¹³⁵. Neni 189(3) i KPP, që është po ashtu risi, detyron Gjykatën e Apelit që të vendosë brenda 48 orëve nga paraqitja e ankesës kundër aktvendimit me cilin shqiptohet paraburgimi. Nuk kishte afat të tillë me kodin e mëparshëm të procedurës.¹³⁶

Në praktikë, prokurorët përgjithësisht përmbushin afatin e ri 24-orësh të përcaktuar në nenin 164(7) të KPP-së. Gjithsej, 72 për qind e avokatëve janë përgjigjur se prokurorët “rrallëherë ose asnjëherë” nuk arrijnë të paraqesin kërkesë për paraburgim brenda 24 orëve pas arrestit, dhe 87 për qind e gjyqtarëve janë përgjigjur njëjtë. Por, 48 për qind të avokatëve që iu përgjigjën pyetësorit theksuan se kur paraqesin ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për paraburgimin e klientit të tyre, Gjykata e Apelit “shpesh” nuk arrin të merr vendim brenda 48 orëve pas ushtrimit të ankesës dhe 60 për qind e prokurorëve janë përgjigjur njëjtë. Në fund, 57 për qind e gjyqtarëve janë përgjigjur se Gjykata e Apelit “herë pas here” ose “shpesh” nuk arrin ta përmbush afatin. Raporti i Konsoliduar i KGJK-së konfirmon se këto afate nuk respektohen në ankesa.

¹³³ Duhet theksuar se kërkesa për të realizuar padi për kompensim mund të parashtrohet në çdo kohë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor para Gjykatës Themelore (neni 460 KPP).

¹³⁴ Neni 248(2) i KPP thekson “mund”.

¹³⁵ KPPP nuk përcaktonte afat për prokurorin për parashtrimin e kërkesës për paraburgim. Neni 14 i KPP thjeshtë përcaktonte se një person i privuar nga liria nën dyshimin e kryerjes së një vepre penale duhet të “sillej para një gjyqtari sa më parë dhe jo më vonë se 72 orë pas arrestit [...]”. Duhet theksuar se Kushtetuta e Kosovës kërkon që “njoftimi me shkrim për arsyet e privimit duhet të paraqitet sa më parë.” Ajo më tutje shton se të gjithë personat e privuar nga liria pa urdhër të gjykatës do të sillen para gjyqtarit brenda 48 orëve nga momenti që personi sillet para gjykatës” (neni 29(2) i Kushtetutës).

¹³⁶ Shih Kapitullin XXXVIII që ka të bëjë me Ankesat kundër aktvendimeve.

Është shqetësuese që ankesat e parashtruara në Gjykatën e Apelit ndaj vendimeve për paraburgim nuk vendosen gjithnjë në kohë. Kjo mund të përbëjë shkelje të së drejtës së të pandehurit për liri.

3.5.2. Afatet kohore për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor

KPP, përmes nenit 314, vendos afate kohore brenda të cilave duhet të përfundojnë gjykimet. Nuk ka pasur kufizime kohore me KPPP. Tani, gjykimi i një rasti në departamentin e përgjithshëm duhet të përfundojë brenda tre muajve ose brenda katër muajve për një rast pranë departamentit të krimeve të rënda. Shqyrtimi gjyqësor mund të zgjatet me vendim të arsyetuar, nëse ekzistojnë rrethana të veçanta, siç janë numri i pazakontë i madh i dëshmitarëve¹³⁷. Pastaj, shqyrtimi gjyqësor mund të zgjatet për 30 ditë për çdo vendim¹³⁸. Respektimi i këtyre afateve kohore është i domosdoshëm sepse KPP nuk përcakton afate kohore maksimale për caktimin e paraburgimit, pas ngritjes së aktakuzës; në vend të kësaj, paraburgimi është i kufizuar me afatin kohor për gjykimin. Prandaj, gjyqtari duhet të punojnë me zell për ta mbajtur gjykimin sa më shpejt dhe sa më drejtë që të jetë e mundur.¹³⁹

Megjithatë, në praktikë një numër i konsiderueshëm i gjykimeve para departamenteve për krime të rënda nuk janë përfunduar brenda afateve kohore të vendosura në bazë të nenit 314 të KPP-së. OSBE-ja ka monitoruar 31 gjykime para këtij departamenti ku afatet kohore nuk janë përmbytur. Praktika, përgjithësisht, është që të caktohet një seancë njëditore apo gjysmë-ditore në muaj, e cila nuk është e shpeshtë sa duhet për t'i përfunduar gjykimet brenda afateve të vendosura, veçanërisht të atyre para departamentit për krime të rënda, madje edhe nëse supozojmë që të gjitha seancat e planifikuara ishin produktive¹⁴⁰. Jo vetëm që gjykatat nuk i respektojnë afatet kohore, por gjithashtu nuk arrijnë të nxjerrin vendime të arsyetuara për ta zgjatur shqyrtimin gjyqësor. Përgjigjet e dërguara nga avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët në pyetësor konfirmojnë këto shqetësime. Gjithsej, 38 për qind të avokatëve që i janë përgjigjur pyetësorit kanë theksuar që nga janari 2013 “shpeshherë” janë përfshirë, në rastet kur shqyrtimi gjyqësor nuk është përfunduar brenda afateve përkatëse. Megjithatë, vetëm dhjetë për qind e prokurorëve u përgjigj se afatet kohore nuk janë respektuar, ndërsa 63 për qind e gjyqtarëve pranuan se kjo ka ndodhur “herë pas here” ose “shpeshherë”. Edhe avokatët edhe prokurorët theksuan se në rastet kur shqyrtimi gjyqësor nuk është përfunduar brenda afateve, gjykata “rallëherë” ose “asnjëherë” nuk ka lëshuar vendim për zgjatjen e shqyrtimit gjyqësor. Është gjithashtu shqetësuese që gjykatat ndjekin të njëjtën praktikë të caktimit të seancave kur i pandehuri është në paraburgim gjatë gjykimin. Mosrespektimi i afateve të reja kohore të përcaktuara në KPP rrjedhimisht mund ta shkel të drejtën e të pandehurit për gjykim brenda kohës së arsyeshme, si dhe të drejtën për liri.

3.5.3. Data e aktgjykimin me shkrim

KPP i ri përcakton që aktgjykimet me shkrim të lëshuara në fund të shqyrtimit gjyqësor duhet të përfshijnë datën e hartimit.¹⁴¹ Nuk kishte detyrim të tillë me kodin e mëparshëm. Në një

¹³⁷ Neni 314(2) i KPP.

¹³⁸ Neni 314(3) i KPP.

¹³⁹ Udhëzuesi për KPP, f. 26.

¹⁴⁰ Kjo praktikë ka ekzistuar para hyrjes në fuqi të KPP.

¹⁴¹ Neni 370(2) KPP.

raport të lëshuar më 2012, OSBE-ja theksoi se si pasojë e mungesës së datës së shkruar ishte e pamundur për të vërtetuar nëse një aktgjykim është hartuar brenda afatit kohor të përcaktuar me kod (brenda 15 ditëve pas shpalljes nëse i akuzuari është në paraburgim dhe brenda 30 ditëve në raste të tjera).¹⁴² Aplikimi i këtyre dispozitave të reja është thelbësor për të siguruar së respektohet e drejta e të pandehurit në gjykim në kohë.

Megjithatë, në praktikë në vetëm 36 nga 196 aktgjykime të grumbulluara me shkrim kishte dallim ndërmjet datës kur është nxjerrë vendimi me gojë dhe datës së lëshimit të aktgjykimit.

3.5.4. Rishikim i sfidave me aktakuzat

Sipas Udhëzuesit për KPP-në, “ndryshim i rëndësishëm strukturor në procedurë penale është eliminimi i seancës së konfirmimit dhe gjyqtarit për konfirmim. Shumica pajtohen që kjo procedurë në thelb nuk mbron ndonjë të drejtë, por vetëm vinte një barrë të rëndë në kapacitetet gjyqësore.”¹⁴³ Prandaj, seancat e konfirmimit të aktakuzës në kuadër të KPPP-së janë zëvendësuar me shqyrtimet fillestare dhe të dyta me kodin e ri.¹⁴⁴ Procesi i konfirmimit të aktakuzës, siç e shpjegon Udhëzuesi, është “hap i rëndësishëm jetik” në procedurë gjatë së cilës gjyqtari “ofron një rishikim të pavarur të aktakuzës ‘për mbrojtjen e të drejtave të Mbrojtjes kundër akuzave të gabuara apo tërësisht të pabazuara’”.¹⁴⁵

Sipas KPP gjykata menjëherë cakton shqyrtim fillestar që do të mbahet brenda 30 ditëve pas ngritjes së aktakuzës, apo në mundësinë e parë, dhe jo më vonë se 15 ditë pas ngritjes së aktakuzës, nëse i pandehuri është në paraburgim.¹⁴⁶ Gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata cakton një seancë të dytë jo më vonë se tridhjetë ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar. Para seancës së dytë, mbrojtja duhet të ketë paraqitur një kërkesë për hedhje poshtë të aktakuzës sipas nenit 250 KPP. Pas pranimit të kërkesës, gjykata duhet të lëshojë “vendim me shkrim me arsyetim” që ose refuzon kërkesën ose hedh poshtë aktakuzën (nëse kërkesa është e bazuar).¹⁴⁷ Ky nen nuk përcakton një afat para së cilit duhet të lëshohet vendimi. Megjithatë, neni 285(2) i KPP-së thekson që shqyrtimi gjyqësor fillon brenda një muaji pas seancës së dytë.

Në një raport të publikuar më 2010, OSBE-ja ka shprehur shqetësimin që të drejtat e të pandehurve në gjykim të drejtë shpeshherë shkeleshin në seancat për konfirmim të aktakuzës, posaçërisht meqë aktvendimet e konfirmimit të aktakuzës nga gjyqtari shpeshherë përfshinin pak apo fare arsyetim.¹⁴⁸ Me fjalë të tjera, të gjitha aktakuzat janë konfirmuar pavarësisht nëse mbështeteshin me dëshmi të mjaftueshme apo jo dhe pavarësisht nëse cilësimi ligjor i veprës ishte adekuat apo jo.

¹⁴² Neni 369 KPP. Raporti i OSBE-së, *Ekzekutimi i aktgjykimeve* (janar 2012), <http://www.osce.org/sq/kosovo/87005>.

¹⁴³ Udhëzuesi për KPP, f. 21.

¹⁴⁴ Kapitulli XXXII.2. KPPP – Konfirmimi i aktakuzës dhe kapitulli XV KPP – Faza e aktakuzës dhe pranimit të fajësisë.

¹⁴⁵ Udhëzuesi për KPP, f. 55 dhe 57, që citon rastin Dyilo në GJNP dhe Komisionin e lartë të OKB-së për të drejta të njeriut, Raporti i Komisionit kundër Torturës.

¹⁴⁶ Neni 242 (4 dhe 5) KPP.

¹⁴⁷ Neni 250(3) KPP.

¹⁴⁸ Raporti i OSBE-së, *Shqetësimet me konfirmimin e aktakuzave* (nëntor 2010), <http://www.osce.org/sq/kosovo/73712>.

Kjo vazhdon të jetë shqetësim. Gjykatat vazhdojnë të lëshojnë vendime me arsytetime të pamjaftueshme pas kërkesave të mbrojtjes për hedhje poshtë të aktakuzës.¹⁴⁹ Arsyetimi është në të vërtetë shpeshherë i njëjtë nga një vendim në tjetrin: gjyqtarët thjeshtë e cekin faktin që prokurori ka grumbulluar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar që i pandehuri ka kryer veprën penale shkurtimisht listojnë provat e përshkruara në aktakuzë. Argumentet specifike të ngritura nga mbrojtja shpërfillen.

OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar raste në të cilat gjykatat gabimisht kanë zhvendosur barrën e dëshmisë në vendimet e tyre; në vend që të shqyrtojnë nëse prokurori ka paraqitur prova të mjaftueshme në aktakuzë, ata shqyrtonin nëse i pandehuri e kishte bërë këtë në kërkesat e tyre për të hedhur poshtë aktakuzën. Gjykatat pastaj përfundonin se të pandehurit nuk kanë dëshmuar pafajësinë e tyre dhe konfirmonin aktakuzën.¹⁵⁰ Është gjithashtu shqetësuese se gjykatat disa herë nuk lëshonin fare vendim me shkrim, që është shkelje e nenit 250(3) të KPP-së. Gjithsej, 18 për qind të avokatëve që janë përgjigjur në pyetësor kanë theksuar se “rrallëherë apo kurrë” nuk kanë pranuar vendim me shkrim dhe 43 për qind të prokurorëve janë përgjigjur njëjtë.

Një tjetër çështje është se aktvendimi shpeshherë lëshohet nga gjykata me vonesë. Në përgjithësi, 31 për qind e avokatëve që janë përgjigjur në pyetësor kanë theksuar se zakonisht gjyqtarit i duhet më shumë se tri javë për ta lëshuar aktgjykimin, ndërsa 45 për qind të prokurorëve kanë theksuar se zakonisht ju duhen “një deri tri javë”. Kjo është shqetësuese meqë sipas nenit 285(2) të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë brenda një muaji pas shqyrtimit të dytë. Vonesat në lëshimin e vendimeve me shkrim do të rezultojnë me vonesa me fillimin e shqyrtimit gjyqësor.

3.5.5. Audio/video regjistrimi i shqyrtimit gjyqësor

Sipas nenit 315 të KPP-së, duhet të ketë regjistrim me shkrim të gjykimit “të thelbit”.¹⁵¹ Gjykimi gjithashtu duhet të regjistrohet në mënyrë audio dhe video, apo me stenografi, përveç nëse ka baza të arsyeshme për të kundërtën. Kodi i mëparshëm i procedurës përmbante dispozita të ngjashme.¹⁵² Megjithatë, në KPP-në e re është futur një dispozitë e re, me nenin 19(1.27), që shpjegonte se janë tri lloje të regjistrimit në një procedurë penale: përmbledhja, transkripti, regjistrimi. Sipas kësaj dispozite, “përmbledhja është përshkrim i saktë i asaj se çfarë ka thënë një person. Transkripti është regjistrim fjalë për fjalë i asaj çfarë ka thënë një person. Regjistrimi mund të jetë regjistrim audio apo video me anë të mjeteve elektronike që mundëson përsëritjen e saktë të fjalëve që ka thënë një person.”

Në praktikë, seancat e shqyrtimit gjyqësor vazhdojnë të regjistrohen në mënyrë joadekuate. Gjatë periudhës së raportimit, nuk është monitoruar një seancë e vetme me regjistrim në mënyrë video. Me sa duket ka kapacitete të kufizuara për regjistrimin audio apo video apo për regjistrim me stenografi të gjykimeve në Kosovë, meqë gjykatat nuk i posedojnë resurset e nevojshme për një gjë të tillë. Dështimi për të siguruar video regjistrim është një nga çështjet e cekura në Raportin e Konsoliduar të KGJK-së. Përveç kësaj, OSBE-ja është e

¹⁴⁹ OSBE-ja ka shqyrtuar 19 vendime në rastet para departamenteve të krimeve të rënda.

¹⁵⁰ Shih edhe Raporti i OSBE-së, *Rishikim i rasteve penale që kanë të bëjnë me mosdeklarimin e pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë* (nëntor 2015), <http://www.osce.org/sq/kosovo/204291>, f.11.

¹⁵¹ Kuptimi i “thelbit” sipas KPP-së është disi i paqartë dhe do të ishte mirë të kishte deklaratë sqaruese nga Gjykata Supreme përmes një opinioni ligjor.

¹⁵² Neni 348 i KPPP.

shqetësuar se regjistrimet e gjykimeve, në përgjithësi, ishin rrallëherë të sakta në masë të duhur për shkak se dëshmitë e dëshmitarëve shpeshherë parafrazohen dhe/apo përmbledhen në regjistrim. Pyetjet që parashtrohen për dëshmitarët po ashtu rrallëherë regjistrohen. Regjistrimi i parafrazuar i gjykatës pa procesverbal fjalë-për-fjalë, dhe pa regjistrim audio apo video, për një dëshmitar të rëndësishëm, është i pamjaftueshëm për vlerësim të duhur të kredibilitetit të dëshmitarit nga ana e gjykatës. Regjistrimi fjalë për fjalë është realizuar vetëm në 19 për qind të seancave të monitoruara.

Çështja e regjistrimit u bë edhe më problematike në disa raste të monitoruara në vitin 2013 gjatë se cilave përbërja e trupave gjykuese ndryshoi gjatë gjykimit. Më 1 janar 2013, sistemi i drejtësisë në Kosovë u ristrukturua thellësisht me hyrjen në fuqi edhe të KPP-së të ri por edhe të ligjit të ri për gjykatat.¹⁵³ Në periudhën fillestare të zbatimit të ligjit të gjykatave në Kosovë, OSBE-ja ka vërejtur rritje të konsiderueshme të numrit të ndryshimeve në trupat gjykuese që kishin filluar në vitin 2012 dhe vazhduan në vitin 2013.¹⁵⁴ Një apo më shumë gjyqtarë janë zëvendësuar apo i tërë trupi gjykues ishte riformatuar. OSBE-ja ka monitoruar gjykimet në të cilat trupat e riformatuar gjykues kishin vendosur që të mos i ridëgjojnë dëshmitarët të cilët kishin dëshmuar në seancat e mëhershme ndonëse për asnjërin rast nuk kishte regjistrim të dëshmimeve fjalë për fjalë apo me regjistrim audio apo video. Trupat gjykues me përbërje të re kishin në posedim vetëm përmbledhjet e dëshmimeve të dëshmitarëve që shfrytëzuan për të nxjerrë aktgjykimin. Megjithatë, regjistrimi i parafrazuar i gjykatës pa procesverbal fjalë për fjalë apo regjistrimi audio dhe video, për dëshmitarët e rëndësishëm është qartas i pamjaftueshëm.¹⁵⁵

Gjyqtarët duhet të përpiqen të shfrytëzojnë mundësitë e regjistrimit zanor apo audio-video regjistrimit kurdo që të ketë të tilla. Në rastet kur mundësitë e tilla nuk janë në dispozicion, gjyqtari, bashkë me prokurorin dhe nëse ka edhe avokatë mbrojtës të pranishëm, duhet të sigurojnë që procesverbalet të reflektojnë saktësisht atë që është thënë nga palët dhe dëshmitarët gjatë dëgjimit. Prokurori dhe avokati mbrojtës duhet të lexojnë me kujdes të gjitha procesverbalet e shkruara para se ato të nënshkruhen. Për më tepër, kur pala e paditur është e papërfaqësuar, gjyqtari duhet ta këshillojë atë në lidhje me rëndësinë e leximit të thuktë të procesverbalit para se ta nënshkruajë.

¹⁵³ Shënimi 1 më lart.

¹⁵⁴ Kjo ka ndodhur për një numër arsyes. Së pari, Ligji për Gjykatat kërkon që rastet e krimeve të rënda, që tani dëgjojnë në departamentet e reja të krimeve të rënda në Gjykatën Themelore, shqyrtohen nga tre gjyqtarë profesionistë në vend të dy (Ligji për Gjykatat, neni 15(2); KPP neni 25(3)). Së dyti, shumë gjyqtarë janë caktuar në gjykata të reja dhe nuk i kanë përfunduar gjykimet e tyre të pakryera. Së treti, një numër i rasteve nga Prishtina, Peja dhe Prizreni u transferuan në gjykatat e reja të themelore në Ferizaj dhe Gjakovë (Ligji për Gjykatat, neni 39(2)). Së katërti, disa vepra, si mashtrimi në votime, që ishin në juridiksionin e gjykatave komunale, tani bien në juridiksionin e departamenteve të krimeve të rënda dhe kërkojnë kolegji më të madh gjykues (shih neni 15(1.14) i Ligjit për Gjykatat dhe neni 180, Kodi i mëparshëm penal i Kosovës për veprën penale të mashtrimit zgjedhor).

¹⁵⁵ GJEDNJ, në vendimin *P.K. kundër Finlandës (PK vs. Finland)*, GJEDNJ, vendimi më 9 korrik 2002, f. 6.) shpjegonte se, para se të vendosë nëse do të ridëgjojë apo jo një dëshmitar që kishte dëshmuar në seancat e mëparshme para kolegjit të mëparshëm, kolegji i sapo-formuar duhet t'i shqyrtojë me kujdes të gjithë faktorët relevantë, duke përfshirë cilësinë e procesverbalit të dëshmisë paraprake për të siguruar që është respektuar parimi i drejtëpërdrejtshëm.

4. PËRFUNDIM

Me KPP-në e ri, procedurat janë bërë më shumë akuzatore, ndërsa roli i gjyqtarit dhe palëve ka ndryshuar në masë të konsiderueshme. Megjithatë, në praktikë, mbrojtja, prokurorët, gjyqtarët dhe palët e dëmtuara ende nuk kanë marrë përsipër plotësisht rolet dhe përgjegjësitë e tyre të reja.

Ky raport gjen që mbrojtja shpesh nuk përmbush përgjegjësitë e saj të reja në praktikë. Kjo gjetje duhet të kuptohet në kontekstin e veçantë të procedurës penale në Kosovë, ku një numër tejet i lartë i të pandehurve nuk përfaqësohen nga avokatë mbrojtës, jo vetëm në raste para departamentit të përgjithshëm, por edhe në rastet e departamentit për krime të rënda. Në këto raste, mbrojtja përgjithësisht nuk merr përsipër rolin e saj të ri, pasi që nuk ka avokat të pranishëm për të ndihmuar palën e pandehur, ndërsa si të vetme, ato palë zakonisht nuk janë në gjendje të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre. Është e kuptueshme që palët pa përfaqësim nuk mund të përgatiten efektivisht para gjykimit, e as të paraqesin ndonjë argument bindës në mbrojtje të tyre. Gjithashtu, edhe marrja në pyetje e tërthortë është detyrë e vështirë edhe për vetë juristët e kualifikuar, e lërë më për palët pa përfaqësim. Pasi që palët e papërfaqësuara shpesh do të vihen në pabarazi të konsiderueshme kundrejt prokurorisë, ka rëndësi qenësore që gjyqtari të ndërhyjë dhe të sigurojë barazinë e palëve në gjykim.

Në rastet ku avokati mbrojtës është i pranishëm, mbrojtja shpesh nuk angazhohet aq aktivisht në procedura sa do të duhej. Si pasojë, në shumë gjykime, nuk ka ndonjë barazi armësh ndërmjet mbrojtjes dhe prokurorisë, ndërsa të drejtat për proces të rregullt për të pandehurit nuk respektohen sa duhet. Në veçanti, mbrojtja përgjithësisht nuk përgatitet siç duhet para fillimit të vetë gjykimit. Për shembull, mbrojtja shumë rrallë i përdor mundësitë e reja që janë dhënë në KPP-në e ri për të siguruar dëshmi shfajësuese në fazën hetimore përmes prokurorisë. Gjithashtu, ajo rrallë kundërshton zgjedhjen e ekspertit nga prokuroria. Pastaj, gjatë dëgjimit të dytë, mbrojtja gati asnjëherë nuk dorëzon njoftimin për emrin e dëshmitarëve të mbrojtjes që synon të thërrasë në gjykim. Për më tepër, ndërmjet seancës së parë dhe asaj të dytë, mbrojtja shpesh paraqet parashtresa dobët të arsyetuara për rrëzimin e aktakuzës. Gjatë gjykimit, mbrojtja shpesh dështon në kundërshtimin efikas të dëshmive të paraqitura nga prokuroria përmes pyetjeve të tërthorta si dhe për të prezantuar argumente solide në mbrojtje. Në 45 raste të monitoruara, jo vetëm në departamentin e përgjithshëm por edhe në departamentin e krimeve të rënda, edhe nëse të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë, nuk është thirrur asnjë dëshmitar i mbrojtjes e as nuk janë paraqitur argumente të mbrojtjes. Këto raste janë shembuj konkretë të një dështimi të përgjithshëm të mbrojtjes për të ushtruar “përgjegjësitë e zgjeruara” sipas KPP-së së ri.

Prokurorët gjithashtu ushtrojnë rolin e tyre gjatë procedurave njëjtë siç kanë bërë para hyrjes në fuqi të KPP-së së ri. Për shembull, ata nuk kanë ndërruar mënyrën në të cilën ata marrin deklaratat e dëshmitarëve në procedurë paraprake. Në KPP janë shtuar dispozita të reja për procedurën paraprake dhe mënyra se si të përdoren ato gjatë gjykimit. Edhe pse synimi i këtyre dispozitave të hollësishme është që të mbrohet më mirë e drejta e të pandehurit për të marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë, prokurorët vazhdojnë të marrin deklaratat paraprake në të njëjtën mënyrë si me kodin e mëparshëm të procedurës, duke mos bërë kurrfarë dallimi ndërmjet “marrjes në pyetje në procedurë paraprake” dhe “deklaratës në procedurë paraprake”. Dështimi nga prokuroria në zbatim të këtyre dispozitave mund të mos përbëjë shkelje të procedurës penale, por mundet gjithashtu të dëmtojë të drejtën e të pandehurit për gjykim të drejtë. Në fakt, nëse deklaratat në procedurë paraprake përdoret si dëshmi e drejtpërdrejtë gjatë gjykimit për shkak të mosparaqitjes së dëshmitarit, por mbrojtja nuk ka

qenë e pranishme kur është marrë ajo deklaratë në procedurë paraprake, kjo do të rezultojë me shkeljen e të drejtës së të pandehurit për marrje të tërthortë në pyetje për shkak se mbrojtja nuk do të ketë mundësinë adekuate dhe të mirëfilltë për të sfiduar dhe vënë në dyshim dëshmitarin në çfarëdo faze të procedurës. Prokurorët gjithashtu nuk shfrytëzojnë mbështetjen e pohimit, si dhe rrallë negociojnë marrëveshje të fajësisë me mbrojtjen, e as nuk përdorin alternativat tjera ndaj gjyqimit.

Palët e dëmtuara, përkundër statusit të tyre të ri në KPP, përballen me vështirësi në gjetjen e vendit të tyre të ri në procedurë. Ato rrallë dorëzojnë deklaratat e dëmit, ose ato deklaratat nuk shfrytëzohen nga gjykata. Palët e dëmtuara gjithashtu rrallë përfaqësohen nga mbrojtësit e viktimave në rastet e vrasjes apo plaçkitjes, si dhe mbetet e paqartë nëse palët e dëmtuara duhen ftuar për të marrë pjesë në dëgjimin fillestar dhe seancën e dytë.

Përfundimisht, me KPP-në e ri, roli i gjyqtarit është bartur nga një rol tejet proaktiv në një rol më pak proaktiv gjatë procedurës, sepse pala mbrojtëse dhe ajo e prokurorisë kanë marrë më shumë përgjegjësi. Gjyqtari gjithsesi mbetet mbrojtësi i të drejtave të palëve. Ai/ajo ka detyra të reja të shprehura me KPP-në në mbrojtje të këtyre të drejtave. Megjithatë, në praktikë, gjyqtarët nuk marrin përsipër plotësisht këtë rol. Afatet e paraburgimit, përfundimit të seancës kryesore, si dhe nxjerrjes së aktgjyqimit nuk respektohen gjithmonë. Për më tepër, në fazën e aktakuzës dhe deklarimit të fajësisë, mbesin mangësi në procesin e vërtetimit të aktakuzës përkundër dispozitave të reja. Shqyrtimet gjyqësore vazhdojnë të jenë të regjistruara në mënyrë jo adekuate. Këto dështime fitojnë edhe më shumë rëndësi në rastet kur pala e pandehur nuk ka përfaqësim nga avokati. Këto mund të çojnë jo vetëm në shkelje të procedurës penale, por edhe shkelje të të drejtës së të paditurit për gjykim të drejtë.

5. REKOMANDIMET

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës

- Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të ofrojnë trajnime shtesë të thukta për të drejtën procedurale penale për gjyqtarë, prokurorë, si dhe avokatë për t'iu mundësuar atyre që t'i kuptojnë më mirë rolet e tyre në procedurë akuzatore.

Për gjyqtarët

- Në rastet kur nuk përmbushen kushtet për mbrojtje të detyrueshme, gjyqtarët duhet të sigurojnë që të pandehurit të informohen mirë për të drejtën në avokat me shpenzime publike. Nuk mjafton që të informohet pala e pandehur për të drejtën e tij/saj në avokat mbrojtës në mënyrë sipërfaqësore dhe të ngutshme, si detyrim rutinor, pa shpjeguar më mirë këtë të drejtë. Të pandehurit duhet të inkurajohen që të kërkojnë avokat mbrojtës me shpenzime publike për t'i asistuar ata gjatë procedurës gjyqësore.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë që vendimet që aprovojnë apo refuzojnë kërkesën për avokat mbrojtës me shpenzime publike të jenë mirë të arsyetuara. Vendimi duhet që posaçërisht të shpjegojë pse është në interes të drejtësisë në disa raste që të emërohet avokati mbrojtës, si dhe pse gjykata ka konsideruar që pala e paditur nuk ka pasur mundësi financiare që të paguajë koston e mbrojtësit të tij apo saj.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit. Në rastet me palë pa përfaqësim, duhet mbrojtur barazia e palëve ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit.
- Gjyqtarët duhet të përpiqen të shfrytëzojnë mundësitë e regjistrimit në audio apo audio dhe video, kurdo që ato janë në dispozicion. Në mungesë të këtyre mundësive, gjyqtarët duhet të sigurojnë që procesverbali i shkruar saktësisht të reflektojë atë që është thënë nga palët dhe dëshmitarët gjatë seancës. Gjyqtarët gjithashtu duhet të sigurojnë që palët pa përfaqësim të këshillohen në lidhje me rëndësinë e leximit të kujdesshëm të procesverbaleve para se t'i nënshkruajnë.
- Gjyqtarët duhet të marrin aktvendime të arsyetuara mirë në lidhje me kërkesën e mbrojtjes për hedhje poshtë të aktakuzës. Aktvendimet e tilla gjithmonë duhet të jenë me shkrim. Nuk mjafton të nxirret përfundimi që prokurori ka mbledhur dëshmi të mjaftueshme për të vazhduar me gjykim si dhe të renditen shkurtimisht provat e përshkruara në aktakuzë. Përfundimet e tilla gjithmonë duhen mbështetur me arsyetim. Provat duhen analizuar, dhe argumentet e mbrojtjes duhet të trajtohen. Aktvendimet gjithashtu duhen dhënë në mënyrë të shpejtë, ashtu që të mos vonohet fillimi i gjykimit.
- Gjyqtarët duhet të sigurohen që aktgjykimet e hartuara t'i kenë datat dhe jo vetëm datën kur është shpallur aktgjykimi për çështjen.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë që gjykimet të përfundohen brenda tre muajsh në departamentin e përgjithshëm dhe brenda katër muajsh para departamentit të krimeve të rënda.
- Gjyqtarët duhet të nxjerrin aktvendime të arsyetuara për vazhdim të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa ky shqyrtim nuk mund të zgjatet më shumë se 30 ditë me një aktvendim. Respektimi i këtyre afateve kohore është qenësor, pasi që KPP nuk parasheh afate maksimale për paraburgim pas ngritjes së aktakuzës; në vend të kësaj, paraburgimi kufizohet me afatin e gjykimit.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë që deklarimi i dëmeve që dorëzohet nga pala e dëmtuar të shfrytëzohet si kërkesë pasurore gjatë gjykimit, kurdo që është e mundur.

- Pasi pala e paditur të pranojë fajësinë në seancën fillestare dhe nëse pala e dëmtuar nuk është e pranishme në seancë, gjyqtarët duhet të marrin parasysh edhe shtyrjen e seancës për një datë tjetër për t'i dhënë të dëmtuarit mundësinë që të paraqesë qëndrimet e tij/saj dhe/ose për të parashtruar kërkesat e tij/saj pasurore.
- Kur negociohet marrëveshja e fajësisë me shkrim ndërmjet palëve, gjyqtarët duhet të marrin parasysh caktimin e një afati të arsyeshëm jo më të gjatë se tre muaj për përfundimin e negociatave. Çështja nuk duhet shtyrë për periudhë të pacaktuar kohore, ndërsa gjykatat duhet të sigurojnë që procedurat të mos vonohen.
- Gjyqtarët duhet të shqyrtojnë me kujdes kërkesat e prokurorisë gjatë gjykimit për të marrë deklaratat e dëshmitarëve në procedurë paraprake si dëshmi të drejtpërdrejtë kur dëshmitari nuk paraqitet. Gjyqtarët nuk duhet që vetëm të “lexojnë” deklaratën, por duhet edhe të përcaktojnë nëse deklarata është marrë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, apo deklaratës në procedurë paraprake, edhe nëse supozohet që mbrojtja pajtohet me kërkesën e prokurorisë. Gjykatat gjithmonë duhet të sigurojnë që mbrojtja të ketë mundësi adekuate dhe të mirëfilltë për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarin në cilëndo faze të procedurës.
- Gjyqtarët duhet të sigurojnë në fazën e aktakuzës, pa marrë parasysh nëse mbahet seanca e dytë apo jo, që mbrojtja të respektojë obligimin e saj për t'ia dorëzuar prokurorit njoftimin me emrat e dëshmitarëve që synon t'i thërrasë në gjykim. Nëse mbrojtja dështon ta bëjë këtë, gjykata mund të vendosë gjobë deri në 250 EUR ndaj avokatit mbrojtës.
- Gjyqtarët, para fillimit të gjykimit, duhet të sigurojnë nxjerrjen e orarit me renditje në të cilën do të thirren dëshmitarët e propozuar nga palët.
- Gjykata e Apelit duhet të vendosë brenda 48 orësh nga dorëzimi i ankesës kundër aktvendimit për paraburgim.
- Gjykata Supreme duhet të sqarojë nëse pala e dëmtuar duhet të thirret për të marrë pjesë në shqyrtimin fillestar.

Për avokatin mbrojtës

- Mbrojtja duhet të përgatitet efektivisht para se të fillojë gjykimi. Mbrojtja duhet të dijë para fillimit të gjykimit se nga çfarë do të përbëhet rasti i mbrojtjes. Ajo nuk duhet të presë deri në fillim të gjykimit për të mbledhur prova. Rasti i mbrojtjes duhet të parashtrohet, ndërsa dëshmitarët e mbrojtjes të ftohen nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë.
- Mbrojtja duhet të kërkojë me shkrim nga prokuroria që të mbledhë prova shfajësuese, duke përfshirë ekspertizat. Aktvendimet nga prokuroria që refuzojnë kërkesat e tilla duhen mbështetur me arsyetim. Mbrojtja mund t'i apelojë ato aktvendime tek gjyqtari i procedurës paraprake.
- Mbrojtja duhet të marrë parasysh kundërshtimin e përzgjedhjes së ekspertit nga prokuroria, në bazë të kualifikimeve të tij apo saj, apo edhe konfliktit të mundshëm të interesit, duke parashtruar kundërshtimin tek gjyqtari i procedurës paraprake.
- Gjatë shqyrtimit të dytë, mbrojtja duhet t'i dorëzojë prokurorit njoftimin me emrat e dëshmitarëve që synon t'i thërrasë në gjykim.
- Mbrojtja duhet të ofrojë arsyetim të mirëfilltë në kërkesat e saj në fazën e aktakuzës.
- Mbrojtja duhet të përgatitet mirë për marrje në pyetje të tërthortë të dëshmitarëve të prokurorisë.

- Mbrojtja duhet të sigurojë që procesverbali i shkruar të reflektojë saktësisht atë që është thënë nga palët dhe dëshmitarët në çfarëdo dëgjimi. Mbrojtja duhet që të lexojë me kujdes çdo procesverbal para se ta nënshkruajë.

Për prokurorët

- Prokurorët mund të iniciojnë negociatat e pranimit të fajësisë jo vetëm pas ngritjes së aktakuzës, por edhe para saj.
- Prokurorët duhet të marrin në konsideratë dhe të përdorin çdo alternativë të mundshme ndaj gjykimit.
- Prokurorët duhet të dorëzojnë mbështetje të pohimit kurdo që ka nevojë. Ata duhet të mendojnë për provat dhe të gjejnë pohime për provat që nuk janë aq të besueshme, relevante apo bindëse.
- Prokurorët duhet të zbatojnë dispozitat që rregullojnë mënyrën në të cilën merren dëshmitë e dëshmitarëve gjatë fazës së hetimit. Ata duhet të specifikojnë për secilën deklaratë nëse është marrë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake apo në deklaratë në procedurë paraprake, apo në mundësi hetuese të veçantë. Nuk mjafton thjesht të merret “deklarata” nga dëshmitari. Kur mbahen seancat paraprake për deklarata, formalitetet e parapara me ligj duhen respektuar.
- Prokurorët duhet të nxjerrin vendime me arsyetim kur i refuzojnë kërkesat e mbrojtjes për të mbledhur prova shfajësuese. Vendimi mund të apeloher tek gjyqtari i procedurës paraprake.
- Prokurorët duhet të informojnë mbrojtjen për vendimin për caktimin e ekspertit. Mbrojtja pastaj mund ta kundërshtojë këtë vendim tek gjyqtari i procedurës paraprake.
- Prokurorët duhet të sigurojnë që procesverbalet e shkruara të reflektojnë saktësisht atë që është thënë nga palët dhe dëshmitarët në çdo seancë dëgjimi. Prokurorët duhet të lexojnë me kujdes çdo procesverbal para se ta nënshkruajnë.
- Kryeprokurori duhet të marrë parasysh nxjerrjen e udhëzimeve për t’i ndihmuar prokurorët që të kuptojnë se si dhe kur duhet përdorur mbështetja me pohim, si dhe të sqarojë se cili është dallimi ndërmjet dëshmisë të marrë nga marrja në pyetje në procedurë paraprake dhe asaj si deklaratë në procedurë paraprake.

Për mbrojtësit e viktimave

- Mbrojtësit e viktimave duhet t’i inkurajojnë dhe ndihmojnë palët e dëmtuara në parashtrimin e deklaramit të dëmeve, si dhe duhet të sigurojnë, kurdo që është e mundur, që ai deklaramit të përdoret nga gjykata si kërkesë pronësore gjatë gjykimit.
- Mbrojtësit e viktimave duhet të përfaqësojnë viktimat jo vetëm në rastet e trafikimit, dhunës në familje, veprave kundër integritetit seksual, por edhe në rastet e vrasjeve dhe plaçkitjeve.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

- KGJK-ka duhet të marrë parasysh krijimin e një mekanizmi për vlerësimin e gjendjes financiare të palës së pandehur. Ky vlerësim është i domosdoshëm kur vendoset nëse duhet caktuar avokati publik me shpenzime publike për një palë të pandehur, sipas nenit 58 të KPP-së.
- KGJK-ja duhet të sigurojë që audio-regjistrimi dhe/ose audio-video regjistrimi i seancave të jetë teknikisht i mundshëm në të gjitha gjykatat, si dhe që seancat gjyqësore të regjistrohen në audio dhe/ose audio-video, ose që transkriptet të mbahen

në të gjitha seancat, ashtu që të regjistrohen saktësisht të gjitha fjalët e thëna nga çdo palë e pranishme.

- KGJK-ja duhet të marrë parasysh shqyrtimin e praktikave të dënimit në Kosovë. Ky shqyrtim do të ndihmonte në të kuptuarit e arsyeve pse të pandehurit aktualisht e pranojnë fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar dhe të dytë ose gjatë shqyrtimit gjyqësor, në vend se ta negociojnë me prokurorin marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë para se të ngritet aktakuza.

Shqyrtim i zbatimit të
kudit të ri të procedurës
penale në Kosovë